



Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe regjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë.

Raporti përmbledh gjithë premtimet elektorale të deputetëve fitues, gjatë fushatës elektorale të vitit 2017, sipas zonave elektorale dhe forcave politike. Gjithashtu, raporti përmbledh edhe kandidatët për pushtetin vendor të vitit 2015 dhe 2019.

PJESA I


Premtimet elektorale – deputetët fitues në Zgjedhjet elektorale 2017

1. Raport mbi kandidatët për deputet në legjislacionin 2017

Tabela 1. Lista sipas qarqeve


Subjekti	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
PS	4	2	8	7	10	3	6	1	3	4	18	8
PD	1	2	4	3	4	1	4	2	3	5	11	3
LSI	2	1	2	2	2	1	1		1	1	5	1
PDIU		1		2								
PSD										1		

Grafik 1.




Burimi: (llogaritje EIC)

Grafik 2.



Burimi: (llogaritje EIC)

Grafik 3.




Burimi: (llogaritje EIC)

Tabela 2.

Subjekti	Deputetë që kanë dhënë dorëheqje nga mandati	Deputetë me mandat
PS		74
PD	41	2
LSI	17	2
PDIU	2	1
PSD		1
TOTALI	60	80

Grafiku 4.



2. Premtimet e kandidatëve sipas Qarqeve

QARKU BERAT

PS. Lufta për të pastruar administratën nga kunetërit, motrat, kushërinjtë, krushqit etj, që kanë pushtuar zyrat e shtetit sipas partive të pushtetit. (NEPOTIZMI)

PD. Zgjidhja e një ekonomie të fortë dhe të sigurtë, me taksa të ulta, me ulje të TVSH-së, ulje të çmimit të naftës dhe punësim për qytetarët

LSI. Do të hapim në 4 vitet e ardhshme 100 mijë do të jenë vetëm për rininë, sepse prioritet i LSI-së është e ardhmja e rinisë dhe jo e ardhmja e kriminelëve. Unë kam një ëndërr që t'i rikthej vlerat qytetit tim dhe t'ju jap një shans të gjithëve ju.

QARKU DIBËR

PS. Mbështetja për bujqësinë edhe me bërjen 0 të tatimit mbi vlerën e shtuar për inputet bujqësore, si dhe mbështetja e veçantë që do të japim për arsimin profesional për të rejtat dhe të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, por sidomos në Burrel, në Klos, në Bulqizë, në Dibër, për ato çfarë lidhen me mundësitë që kanë këto zona; me bujqësi, blegtori, agro-përpunim, industri të lehtë, miniera një pjese dhe padyshim turizëm, sepse rruga e Arbrit do ta bëjë pjesë të ofertës turistike kombëtare gjithçka që kemi në këtë qark, duke filluar që nga Ulza e duke vazhduar deri lart në Korab.

LSI. Z.Përparim Spahiu, e vuri theksin tek zhvillimi i bujqësisë, duke hapur e vënë në funksion kanalet vaditëse. Ndërkohë ai u kërkoi banorëve që të mos mashtrohen për të dytën herë nga premtimet e z. Edi Rama, për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

PD. Zj. Dhurata Tyli: Rruga e Arbërit brenda mandatit do të bëhet mbarimi i saj. Emergjente është infrastruktura, janë emergjente subvencionet në bujqësi, është pikë e rëndësishme e programit pensioni 25 mijë lekë për pensionistët që është diçka jashtëzakonisht pozitive.

PDIU. Z. Reme Lala: Mbarimi i Rrugës së Arbërit brenda vitit.

QARKU Durrës

Z. Fidel Ylli bën thirrje për mbajtjen e premtimeve nga PS për vazhdimin e reformave në të ardhmen. **Z. Jurgis Cyrbja** premtonte thellimin e reformave në vitet e ardhshme të qeverisjes së

PS. Z. Roland Xhelilaj theksoi se në 4 vitet e ardhshme do të ndërtojmë shtet, për të pasur më shumë punë dhe mirëqenie. **Zj. Milva Ekonomi:** do të sigurojmë më shumë produkte Made in Albania.

Duhet t'i kthejmë dinjitetin vendit, të favorizojmë ekonominë, bujqësinë. Vetëm një koalicion mund ta bëjë këtë, Partia Demokratike, Republika e Re,” tha z. Basha. **Z. Oerd Bylykbashi** në zonen e Ish Kënetes ka premtuar ndryshim rrënjësor të kësaj zone. Demokratët premtuan ndryshim rrënjësor të gjendjes së tyre përmes programit ekonomik që ul maksimalisht taksat. **PD** ka premtuar ulje të tvsh-së dhe taksë të sheshtë 9%. Ata parashikojnë se me uljen e taksave biznesi do marrë frymë, do të rriten pagat e do të hapen të tjera vende pune.

Zj. Nora Malaj u shpreh se **LSI** është forca kryesore dhe e vetmja që mund të realizojë premtimet për qytetarët. **Z. Lifter Koka** tha se LSI-ja ka një mision në këto zgjedhje. “Misioni ynë është të largojmë rilindjen”, Rilindja duhet të largohet për shkak të kanalizimit të vendit dhe dhunës që po ushtrohet ndaj administratës. LSI-ja ka një plan për zhvillimin e vendit dhe punësimin.

QARKU ELBASAN

Në 4 vitet e ardhshme ekonomia do rritet mbi 5%, rroga minimale 30 mijë lekë, pagat do të rriten 40%, pensionet do të rriten vit për vit. Edi Rama premtoi rritje të punësimit dhe ekonomisë nga Elbasani.

Basha tha se PD synon uljen e taksave si dhe mbështetjen për prodhuesit vendas. “Taksa të ulëta, mbështetje për bizneset që hapin vende pune. 10 mijë stazhe për të rinjtë çdo vit të paguara nga shteti. 100 milionë euro subvencione për fermerët. Një plan ekonomik, që ul taksat, rrit pensionet, rrit konsumin, rrit prodhimin, siguron mbështetje për njerëzit në nevojë, shkolla të mira me drekë të paguar për fëmijët dhe ndihmë të drejtpërdrejtë për fermerët. Kjo është oferta për shqiptarët, një plan ekonomik që funksionon në Europë.

Zj. Monika Kryemadhi: ka shtuar se në programin e LSI-së do të garantohen vende të reja pune të mirëpaguara për të rritur mirëqenien e qytetarëve duke e afruar edhe më shumë Shqipërinë drejt Bashkimit Evropian. Duke garantuar vende pune të mirëpaguara, duke garantuar shitjen e prodhimit, duke garantuar subvencionin në bujqësi, duke garantuar infrastrukturën në bujqësi, ne mund të realizojmë ëndrrën tonë, ëndrrën e Bashkimit Evropian.

PDIU. Forcimi i rolit të gruas dhe më shumë mbështetje nëpërmjet punësimit e politikave favorizuese, ishin disa nga premtimet që kandidatët e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet.

QARKU FIER

Z. Erjon Braçe ka premtuar hapjen e 220 mijë vende pune. Ngritja e një spitali ekselent në Fier (kjo ishte në zotimet e kongresit të zhvilluar të PS). Investime në bujqësi duke garantuar grante për fermerët. Përgjithësisht nga kandidatet e PS në rajonin e Fierit kanë shpalosur të gjitha premtimet që janë bërë në kongresi paraardhës të PS. Duhet të theksojmë që kishte nga kandidatët e PS, që janë pritur me portesta nga banorët për mos realizim të premtimeve të para të bëra nga Qeveria Rama 1.

PD ka premtuar ndryshimin, që vjen nga ekonomia e fortë, në themel të programit të PD-së. Ekonominë e fortë të Fierit. Republika e Re do të jetë ekonomia e taksave të ulëta për vogëlushet dhe vogëlushët e Fierit do të marrim mësim me staf të shtuar dhe me drekë e paguar nga Republika e Re.

Z. Petrit Vasili: Objektivi kryesor që ne kemi vendosur është 5-fishimi i buxhetit të shtetit në fushën e bujqësisë, duke arritur në nivelin e 250 milionë eurove në vit. Pra, një 5-fishim i cili është rrënjësor dhe transformues për këtë fushë kaq të rëndësishme të jetës sonë ekonomike dhe shoqërore, pasi lidhet me fatet e mijëra njerëzve. “Ky financim, pra ky pesëfishim, lidhet me krijimin e rreth 50 mijë vendeve të reja pune. Në nga gjërat më të rëndësishme që realizon këtë rritje, do të thotë dyfishim të prodhimit kombëtar në fushën e bujqësisë dhe automatikisht, më e pakta është dyfishimi i të ardhurave të çdo familjeje dhe çdo fermeri.

QARKU GJIROKASTËR

Z. Blendi Çuçi deklaroi se gjatë mandatit të dytë, me përfshirjen e Gjirokastrës në një paketë 71 milionë dollarë nga Banka Botërore, projektet transformuese të Gjirokastrës do të shtrihen në çdo lagje të saj. Kërkoi mandat fuqiptotë për Partinë Socialiste, duke theksuar se PS ka dëshmuar se është e vetmja forcë politike shtetformuese e aftë për të çuar më tej procesin e integritit europian.

PD. Ulje të taksave me 9%, heqjen e TVSH, ulje të çmimit të naftës, rritje të ekonomisë në këtë zonë që të ketë zhvillim si dhe më shumë turistë të cilët do të sjellin të ardhura.

Punësimi dhe investimet janë prioritetet e **LSI-së** në këtë qark

QARKU KORÇË

Z. Edi Rama foli për një transformim rrënjësor të Korçës dhe gjithë qarkut. Ai tha se në katër vitet e ardhshme, investimet do të shtrihen në periferi. **Z. Niko Peleshi:** Do të marrim 7, 8 mandate të sigurta në këtë qark, jo për të pasur më shumë pushtet, por ne na duhen 71 për të

qeverisur vetëm, për të pasur më shumë mundësi. Peleshi sqaron projektet konkrete duke filluar nga investimet në rrugë, projektet për hekurudhën, ndërtimin e nje aeroporti në Korçë e deri tek investimet ne sektorin e turizmit.

Zj. Valentina Duka: PS është parti në pushtet, ka hapësira të mashtrojë njerëz, duke ofruar punësim në kohën e fundit, duke rregulluar rrugë në kohën e fundit, duke i detyruar njerëzit të pijnë kafe në ato kafenetë e atij pazari që u ndërtua, por nuk ka asnjë funksion. Ne jemi shumë të avaztazhuar për shkak të varfërisë dhe papunësisë se madhe, ata nuk kanë asnjë avantazh tjetër veçse të punësuarit e tyre të votojnë për to do të kenë mundësi të punësohen, varfëria do të largohet për shkak se ne do të mundohemi të ndërtojmë struktura të mëdha dhe të vogla prodhuese ku do të mbështesim dhe fermerët.

Ne jemi e vetmja forcë politike që ka një alternativë të qartë, të besueshme e bindëse”, tha **z. Panariti**, duke theksuar se, “koalicioni blu-mavi nuk ka asnjë objektiv tjetër, veç sulmeve ndaj **LSI**-së dhe stigmatizimit tonë, nga frika dhe paniku që i ka kapur, si rezultat i rritjes”. **Z. Panariti** ka premtuar 5-fishimin e fondeve per bujqesine ose me saktë të fermerëve të Korçës. Bujqësia është i vetmi sektor i këtij vendi që e mbyll krejt ciklin: prodhon, përpunon, paketon, ambalazhon, çon në tregun vendas, çon në eksport dhe ndaj gjithnjë e më tepër shihet si sektor motor i ekonomisë kombëtare.

QARKU KUKËS

Zj. Mimi Kodheli për të bërë të mundur rikualifikimin e qendrave urbane të qyteteve të Kukësit, Bajram Currit dhe Hasit. Kodheli u shpreh ose shpalosi premtimin e saj, deri më tani është ndërtuar çdo kryeqendër e Shqipërisë dhe do të ndërtohet çdo kryeqendër e çdo njësie administrative dhe fshati të Republikës së Shqipërisë në katër vitet që do vijnë. **Z. Safet Gjici** premtoi ndërtimin e rrugës së Kalisit në vitin e parë të mandatit katër vjeçar.

PD. Ndryshimi ekonomik. Janë taksat e ulëta, është ulja e TVSh-së, është largimi njëherë e mirë i terrorit mbi sipërmarrjen dhe njerëzit e thjeshtë. Është mbështetja me subvencione për fermerët kuksianë, hasianë dhe tropojanë. Është injektimi i 400 milionë eurove në xhepat tuaja vetëm me uljen e TVSh-së për të ringjallur konsumin, prodhimin dhe vendet e punës.

QARKU LEZHË

Zj. Lindita Nikolla: Beteja për punësimin dhe mirëqenie si dhe vazhdimi i reformave në drejtësi. Rritja e punësimit dhe zhvillimi ekonomik sipas dokumentit do të çojë në përmbushjen e zotimit të katërt, rritjes me 25 për qind të të ardhurave të disponueshme për çdo qytetar.

Z. Aldo Bumçi: Rritja ekonomike arrihet me dy mënyra, duke rritur pensionet, nuk do të ketë pension më të ulët se 25 mijë lekë dhe te gjitha familjet që janë në ndihmë ekonomike do ti mbulohet energjia deri në 300 kë dhe fatura e ujit të pijshëm.

Rritje të kapaciteteve manaxhuese dhe financiare në formimin profesional në hoteleri turizëm. Përfshirjen nga taksa dhe tatim fitimi për 5 vite të sipërmarrësve turistik, në zonat rurale, dhe malore me popullsi të ulët. Mbështetje të sektorit turistik me kredi të buta 2% si dhe aplikimi i granteve për SME. **Z. Viktor Tusha:** LSI ka një program të qartë për mbështetjen e të rinjve të cilët duhet ta shohin të ardhmen të lidhur me vendin e tyre. Programi i LSI garanton 100 mijë vende të reja pune për rininë, ulje të taksave për biznesin, ulje e tatimit mbi pagën etj.

QARKU SHKODËR

Z. Ditmir Bushati në Vau i Dejës ka premtuar një pikë frigoriferike për grumbullimin e produkteve bujqësore, për t'ju gjendur në krah sakrificave dhe punës së njërëzve për tua bërë jetën më të lehtë. Punësim dhe rritje ekonomike.

PSD. Z. Tom Doshi, premtoi se do të mbështeste Vllazninë në sezonin e ardhshëm, që të formojë një skuadër të mirë ndryshe nga 5 vitet e fundit. Gjithashtu ai është shprehur "Vota jote është prap e jotja, sepse ajo votë nuk do të shpërdorohet. Ajo votë është prap e juaja sepse unë jam i juaji. Partia ime është elektorati dhe besim te zoti. Unë betohem se nuk do t'ju tradhetoj kurrë. Do të përfaqësoj të gjithë. Na besoni dhe na votoni sepse ne do të luftojmë korrupsionin edhe në Shkodër. Unë kam dalë hapur, i vetmi në atë Parlament që kam luftuar korrupsionin".

PD. Z. Basha: Qindra milionë euro që do të nxisin prodhimin, që do të çojnë në rritjen e kërkesës për vende të reja pune, kreditim, investime kapitale. Ky është modeli që ka funksionuar në Europë. Ulja e taksave, subvencione për fermerët, stazhe për të rinjtë dhe mbështetje për çdo biznes që hap vende të reja pune. **Z. Lulzim Basha** shtoi se Republika e re do të vendosë standarde demokratike

LSI. Punësim i të rinjve dhe rritje ekonomike. Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit.

QARKU TIRANË

Z. Arben Ahmetaj: Rritje të ekonomisë 5.5 %, mbajtje të investimeve publike në masën 5 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ulje të borxhit në 60% të PPB. **Zj. Olta Xhaçka** pensionistët do të kenë rritje të pensioneve të tyre. Në vitin e parë të mandatit do të kenë shpërblimin e fundvitit që do të shkojë nga 7 mijë - 10 mijë Lekë. Mbështetje e shtresave në nevojë.

Zj. Ogerta Manastarliu. standarte të reja për rastet e urgjencave, si dhe prioritet do jenë hapja e vendeve të punës për të rinjt.

Zj. Rudina Hajdari: Përgjatë mandatit 4-vjeçar, zgjidhja e problemeve infrastrukturore, në mënyrë të pashmangshme do të ketë një impakt mjedisor. Ne do të bëjmë maksimumin tonë për ta minimizuar këtë dhe do të orientohemi nga kornizat ligjore të BE-së për të zbatuar praktikat më të mira. Përmes një planifikimi efektiv, përdorimi i energjisë diellore mund të reduktojë disa nga problemet e zonës sime, me një kosto eficiente. Do të mirëprisja çdo strategji mjedisore, nga cilido aktor, që do të minimizonte emetimet e CO2, por duke prioritetizuar nevojat jetike të këtyre qytetarëve që, megjithëse jetojnë rreth 185 km larg BE-së, ngjan me një zonë të botës së tretë”.

Zj. Grida DUMA: Ulja e TVSH-së së energjisë, ulja e çmimit të energjisë është një detyrim dhe drejtësi sociale, jo vetëm sepse energjia në Shqipëri është më e shtrenjta në rajon, por sepse rrjeti i amortizuar e çon 40% të energjisë në humbje gjatë shpërndarjes. Është premtimi ynë që në familjet pa të ardhura, pensionistët që jetojnë të vetëm, konsumi deri në 300 kw që është konsumi minimal jetik të përballohet nga shteti.

LSI ka premtuar se nëse udhëheq qeverinë do të hapi 170 mijë vende pune, 100 mijë prej të cilave për të rinjtë.

QARKU VLORE

Z. Damian Gjikhuri ka thënë - Shqipëria duhet të fillojë nga shteti, sepse pa shtet nuk ka investime, as punë, as mirëqenie. Shikoni të gjitha investimet që janë bërë në Vlorë, nuk janë rastësi, por gjithçka vjen nga një dashuri për këtë vend dhe për t’i kthyer Vlorës atë që i ka dhënë historisë.

PD. Duhet një plan për ta nxjerrë Shqipërinë, një plan i zbatueshëm si ky që kam unë, një plan ekonomik i ngjashëm me atë që po aplikon sot presidenti Trump, me ulje taksash, ndihmë për sipërmarrjen për të krijuar vende pune, me investime në infrastrukturë që ndihmon zhvillimin dhe jo infrastrukturë rrush e kumbulla” tha **z. Basha**. Dua ta mbyll me një premtim për një degë të veçantë të turizmit që ka të bëjë me gjuetinë. Gjuetia në asnjë vend nuk ndalohet, por normohet dhe kontrollohet. Ndalimi i gjuetisë ka pasur një qëllim, të hiqte sytë dhe veshët e gjuetarëve nga mbushja e maleve, kodrave dhe pyjeve të Shqipërisë me hashash” tha zoti Basha.

Z. Rrokaj: Nga do të hidhen tifozët një drejtim i majtë i bën mirë Shqipërisë, por një drejtim i majtë dinjitoz ku interesat e vendit vihen në plan të parë përballë kapriçove të politikanëve.

Z. Rrokaj: LSI është shpresë dhe shans për të rinjtë, të cilëve u bëri thirrje që ta ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri. Rrokaj: Jemi një shans sepse ne premtojmë se me ardhjen në

qeverisje ne do të hapim 100 mijë vende pune për të rinjtë. Kryesuesi i listës së **LSI**-së në Vlorë, z. Shezai Rrokaj, përsëriti premtimet për ekonomi më të forte dhe më shumë vende pune

PJESA II

Raport mbi kandidatët fitues për pushtetin vendor të vitit 2015 dhe 2019

1. Rezultatet për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive

Tabela 1. Rezultatet për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive 2015 dhe 2019


Subjekti zgjedhor	Numri i kryetarëve të zgjedhur 2015	Numri i kryetarëve të zgjedhur 2019
ASHE	45	61
APPD	15	
MEGA	1	1
TOTALI	61	61

- * Shënim: ASHE – Koalicioni për Aleanca për Shqipërinë Evropiane
APPD – Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
MEGA- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen

Në zgjedhjet vendore të 21 qershorit 2015 për zgjedhjet vendore në Republikën e Shqipërisë u krijuan dy koalicione të mëdha, ai i Aleancës për Shqipërinë Evropiane më 37 parti dhe ai i Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet me 15 parti. Gara e vërtetë elektorale u zhvillua ndërmjet dy koalicioneve për kryetarët e bashkive. Koalicioni ASHE-së fitoi në 45 bashki, ndërsa APPD në vetëm 15 bashki. Një bashki, ajo e Finiqit, është fituar nga kandidati i Partisë MEGA.

Ndërsa në zgjedhjet e 30 qershor 2019, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019. Më 30 qershor shqiptarët votuan për 61 kryetarët e bashkive, në zgjedhjet vendore të 2019. Zgjedhje jo të zakonshme, për herë të parë pa opozitën. Partia Socialiste i ka fituar të gjitha Bashkitë në këto zgjedhje, për shkak të bojkotit të opozitës, me përjashtim të njëjës. Bashkia e Finiqit është fituar nga partia Mega. U regjistruan si subjekt zgjedhor 2 koalicione zgjedhore: Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Evropiane me (21 Parti) dhe Koalicioni Shpresa për Ndryshim me (6 Parti) si dhe Parti Politike, që kandiduan si të pavarura ishin (9 Parti).

Grafik 1.



Burimi: (llogaritje EIC)


Përfaqësimi i Grave

Kodi Zgjedhor u ndryshua në Prill 2015 për të pasqyruar ndarjen e re të njësive të qeverisjes vendore. Sa i përket përfaqësimit gjinor në listat e partive dhe koalicioneve konkurruese u bënë ndryshime të rëndësishme, sipas të cilave, listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë duhet të përmbajnë 50 përqind të secilës gjini dhe çdonjëri në dy emra duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Listat, që nuk e përmbushin kushtin e përfaqësimit gjinor nuk u pranuan për regjistrim nga KQZ-ja.

Tabela 2. Përfaqësimi Gjinor në 2015 dhe 2019

Subjekti Zgjedhor	Femra		Meshkuj	
	2015	2019	2015	2019
ASHE	8	8	37	52
APPD	1		14	
MEGA	0		1	1
TOTALI	9	8	52	53

Grafik 2.




Burimi: (llogaritje EIC)

Tabela 3. Rikandidime për të zgjedhurit vendor

Subjekti zgjedhor	2019	
	Rikandidim i kandidatëve për njësitë vendore	Të zgjedhur të rinj
ASHE	23 (38 %)	38 (62%)
Totali	23	38

Grafik 3.



Burimi: (llogaritje EIC)

2. Premtimet e kandidatëve që kandiduan në vitin 2019

Z. Sotiraq Filo, Bashkia e Korçës

Objektivi im kryesor në këtë mandat, është që modelin e sukseshëm të menaxhimit të bashkisë së Korçës, që solli si rezultat transformimin e qytetit dhe rikthimin e besimit dhe shpresës tek banorët, ta shtrij tek çdo fshat që na bashkohet. Zhvillimi dinamik sipas një plani konkret veprimi i çdo hapësire brenda territorit të bashkisë të re, unifikimi i standardit të infrastrukturës me rrjet të rehabilituar kanalizimesh, uji të pijshëm në çdo fshat, rrugë e sheshe të rikonstruara, do të jetë veçse hapi i parë për këtë qëllim.

Fshatrat përreth kanë nevojë për disa ndërhyrje të shpejta, emergjente, të cilat kërkojnë pak investim por kanë impakt të rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të jetesës. Ndriçimi i hapësirave publike në fshat, sistemimi i rrugëve të brendshme dhe shesheve, uji i pijshëm, qendrat shëndetsore etj do të jenë ndërhyrjet e para si pjesë e planit 300-ditor të bashkisë.

Jo vetëm projekte për zhvillimin infrastrukturor, por edhe paketa projektsh dedikuar bujqësisë, punësimit, të rinjve, moshës së tretë, projekte të cilat në kompleks do të bëjnë të mundur që edhe këto zona ku banon gati 30 për qind e banorëve të territorit të bashkisë të hyjnë në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm, që edhe banorët e këtyre zonave t'u hapet një perspektivë e re, më mundësi konkrete për arsimim më të mirë, kujdes shëndetësor më të mirë, vëmendje më e madhe për shtresat në nevojë, mundësi punësimi veç sektorit të bujqësisë, mundësi argëtimi për fëmijët e të rinjtë dhe mundësi të shtuara për një cilësi jete më të mirë.

Do të zgjerojmë hartën e fshatrave turistike të bashkisë me një program të integruar zhvillimi për të ndërtuar profile të veçanta dhe atraktive si:

Rruga e shijes (Boboshticë – Drardhë) Ky do të jetë një rrjet restorantesh, bujtinash që do të promovojnë gatimet tradicionale të zonës, do të ketë tregje me produkte bio të zonës dhe festivale ushimesh tradicionale.

Rruga e Qumështit (Bulgarec – Çiflig) Ky do të jetë një rrjet fermash të prodhimit dhe përpunimit të nënprodukteve të qumështit dhe përpunimit të mishit dhe në këtë zonë kemi planifikuar të zhvillojmë modelin e turizmit të fermave.

Rruga e frymëzimit (Mborje – Drenovë) Ne kemi planifikuar rivitalizmin e aksit përgjatë Përroit të Bozdovecit dhe Përroit të Mborjes me gjelbërim, hapësira çlodhëse, shëtitore buzë lumit, ura lidhëse duke krijuar një park frymëzimi mes Mborjes dhe Drenovës.

Investimet në këto zona, si pjesë e programit të zhvillimit, do të realizohen përmes investimeve publike, partneritetit publik-privat dhe skemave të incentivave me taksa të ulta, grante dhe kredi të buta.

Brenda vitit të parë të mandatit do të ndërtojmë Terminalin e ri të Autobusëve në hyrje të qytetit, duke liruar përfundimisht hapësirën përbri pazarit dhe vendet e tjera të parkimit të autobusëve të linjave në Korçë. Brenda vitit të parë do të përfundojmë fazën e fundit të shtrimit të kanalizimeve në qytetin e Korçës dhe do të fillojmë nga puna për zgjerimin e kësaj harte me çdo fshat të bashkisë së re.

Do të ndërtojmë Unazën Turistike të bashkisë e cila do të thotë lidhje me infrastrukturë rrugore e zonave turistike me afërsi gjeografike. Do të përmirësojmë infrastrukturën rrugore, ndriçimin dhe do të bëjmë rikonstruksionin e monumenteve të kulturës në fshatrat turistike Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq. Gjithashtu parashikojmë mbështetjen me grant për ndërtimin e rrjetit të 50 bujtinave tradicionale në qytetin e Korçës dhe zonave turistike, ndërtimin e pistës së skive dhe kompleksit turistik dimëror në Dardhë dhe Voskopojë, ngritjen e rrjetit të Zyrave të Informacionit Turistik në qytet dhe fshatra turistike, si edhe organizimin e festave dhe eventeve të reja që promovojnë traditat, kulinarinë, artizanatin në bashkinë e re, duke shfrytëzuar traditat dhe karakteristikat e fshatrave përreth Korçës.

Brenda vitit 2015, do të organizohet struktura e posaçme në bashki e cila do të ketë nënndarje të veçanta për problemet e tokës, tregut bujqësor, menaxhimit të ujit, të mbetjeve, prodhimit, përpunimit etj. Menaxhimi i tokës do të jetë prioritet i punës në vitet e ardhshme duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm të aktiviteteve bujqësore dhe jo bujqësore që lidhen me token.

Z. Sotiraq Filo, premtoi se pranë bashkisë së Korçës do të ketë një Agjenci Mbështetje për Investimeve. Kjo agjenci, do të jetë një strukturë e posaçme për nxitjen e investimeve në sektorë të ndryshëm në të gjithë territorin e bashkisë së re, për të pasur më shumë mundësi për biznes, zhvillim dhe punësim. Bashkia do të vazhdojë të tregojë vëmendje të madhe për strehimin, si një nga problemet që ka nevojë për zgjidhje. Ai bëri me dije se 70 banesa me kosto të ulët për të pastrehët, do të ndahen vetëm brenda vitit të parë të këtij mandati të ri.

“Për herë të parë do të ofrojmë truall falas të pajisur me infrastrukturë për ndërtimin e 55 banesave të reja për familjet e reja. 100 bonuset e strehimit të ndara vetëm këtë vit, do të pasohen nga 300 të tjera. Për herë të parë në këtë mandat do të ndërtojmë banesa sociale për familjet pa të ardhura duke ndikuar kështu konkretisht në zgjidhjen e problemit të strehimit”.

Z. Dritan Leli, Bashkia e Vlorës

Do i japim zgjidhje përfundimtare problemit të mbetjeve dhe do të ndërtojmë landfillin; Do të përmirsojmë pastrimin e qytetit dhe grumbullimin e mbeturinave; Do të fillojmë projektet për riciklimin e mbetjeve urbane; Do të vendosim në punë impjantin e ujrave të zeza; Do të ndalohet kategorikisht djegia e e mbeturinave në territorin e Bashkisë Vlorë.

Do të ndalohet derdhja e ujrave të zeza në det dhe janë evidentuar 18 pika që shërbejnë si grykëderdhje, çka do të shmangë ndotjen e detit; Do të përfundojmë rrugën transballkanike, dhe Bay Pasin e ri; Investime ne 8 akse kryesore të qytetit; Do të ndërtojmë Lungomaren; Do të lidhim fshatrat me rrugët nacionale; Do të furnizojnë me ujë të pishëm 24 orë banorët e Vlorës; Do të miratojmë planin rregullës për bashkinë e madhe të Vlorës; Do të sistemohen sheshet, rrugët, trotualet dhe e gjithë infrastruktura e brendshme e qytetit; Do të ndërtohen rrugët dhe pedonalet për biçikletat; Do të gjelbërojmë hapësirat e lira dhe do të pyllzojmë kurorën e qytetit të Vlorës; Do të disiplinojmë qarkullimin e automjeteve dhe parkimin.

Do të ndricojmë rrugët dhe ambientet publike; Do të shkrtohen daljet në bregdet për fshatrat në periferi të Vlorës; Do modernizojmë transportin publik; do të ndërtohet terminali i transportit të qytetit; Do të përmirsojmë kushtet në kopështe dhe çerdhe; Do të ndërtojmë kape verore për fëmijët në të gjithë Vlorën; Trajtim të barabartë për mbledhjet e taksave dhe tarifave; Transparencë publike për çdo vendimarrje; Portal unik për shërbimet; Votim qytetar për projektet e rëndësishme. Referendume lokale. Qytetarët do të jenë pjesë e vendimarrjeve për qytetin. Banorët do të votojnë nga kopjuterat e tyre për çdo projekt që ata duan për Vlorën. Ky projekt

rrit transparencën dhe vendimarrjen qytetare. Projekt të madh pilot për regjistrimin e pronave pasi paisja e pronave me dokumente është domosdoshmëri. Do të bëj të pamundurën që kjo çështje të marrë një zgjidhje gjatë mandatit tim 4-vjeçar. Pas katër vitesh, çdo pronë e juaja do të vlejë shumë më tepër; Master plan për sistemet e kullimit dhe vaditjes; Tregje te reja për prodhimet bujqësore dhe blektorale; Markatë të re për prodhimet e detit; Siguri për produktet ushqimore; Do të ndihmojmë fermerët duke i bërë publicitet pa kosto; Turizmi, investim në cilësinë e shërbimit. Të arrijmë të bëjmë që turisti që largohet dhe të ketë dëshirë të kthehët sërish; Të shndërrojmë Sazanin dhe Karaburunin një pikë të rëndësishme për turizmin; Sezoni turistik nuk do jetë vetëm 45 ditë por do të jetë 365 ditë; Do të organizojmë festa dhe do të ngremë zyra promovuese në qendrat e rajonit; Do të promovojmë festat e të gjithë krahinave të tjera, duke bërë një pelegrinazh turistik; Do të rinovojmë lagjen Muradie, rrugën Justin Godart; Orikun e Vjetër, Kalanë e Kaninës, Ishullin e Zvërnecit do t'i shndërrojmë në destinacione të mirfillta turistike me gjithë infrastrukturën që i nevojitet; Do të ndërtojmë parkun e ri në Pyllin e Sodës, deri tani një kënd që vetëm shfrytëzohet por jo prej qytetarëve.

Do të punësojmë më shumë gra dhe vajza; Do të ndërtojmë qendrën ditore për të moshuarit ku do të ofrohet një shërbim i munguar në një ndër qytetet më të rëndësishme në vend për këtë kategori sociale; Do të ndërtojmë qendra kulturore për fëmijët dhe terrene sportive; Do të krijojmë kushte dhe më shumë infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuar; Do të ofrojmë punësim sezonal për familjet në nevojë; Do të ndërtojmë kinemanë e Vlorës; Laborator të specializuar në shkolla që fëmijët të mësojnë më mirë nesër; Do të mbështesim nxënësit e shkëlqyer dhe studentët e shkëlqyer; Do të organizojmë Festivalin Folklorik Mesdhetar; Do të rihapim pishinën sportive të notit; Do të organizojmë evente sportive ndërkombëtare, dhe Flamurtarin do ta bëjmë kampion. Zhvillim urban, ekonomik dhe social, kjo është në Aleancë me arkitektët dhe urbanistët për qytetin dhe pjesëmarrje qytetare në vendimarrje.

Z. Erion Veliaj, Bashkia e Tiranës

Takim me banorë të vjetër të Tiranës

Liqenin e Kasharit do ta bëjmë park siç është ai i Liqenit Artificial.

Takim në Njësinë Nr. 10

1. Të integrojmë linjat urbane me linjat rurale dhe të çojmë nga 10 në 19 ose 20 linja në territorin e bashkisë së re të Tiranës.
2. Dyfishimi i linjave do na sigurojë më pak trafik në Tiranë pasi përmirësohet cilësia e transportit publik.

3. Do të mundohemi të zhdukim pabarazinë mes shkollave, kopshteve, çerdheve të qytetit me ato të fshatrave.
4. Në 4 vitet e para, për 1 milionë banorë të kemi 100 kopshte dhe 200 shkolla.

Takim me ambientalistët

1. Jemi të vendosur që të gjitha të ardhurat që do të mbliken nga parkingu; do të jenë të destinuara për gjelbërimin e qytetit.

Kashar

1. Tirana do të ketë minimalisht 4 tregje në të gjitha pikat hyrëse dhe kjo do të sjellë treg të sigurtë të prodhimeve tuaja.

Takim në Njësinë Nr. 4

Në mbledhjen tonë të parë, vendimi që do të merret është shpërndarja e banesave sociale dhe ata i përfitojnë ato, do të bëhen publik.

Takim me të rinjtë

- * Do të themelojmë Këshillin e të Rinjve
- * Do të ketë buxhet për rininë
- * Karta e studentit do të bëhet realitet
- * Shkollat do të shihen edhe si qendra komunitare
- * Do të rrisim sigurinë në shkolla
- * Do të nxisim sipërmarrjen rinore
- * Ekipet sportive dhe kampionatet mes shkollave, realitet
- * Do të themelohet inkubatori i biznesit
- * Qendrat rinore do jenë realiteti i Tiranës

Takim për shkollat

1. Do të sigurojmë ngrohjen në çerdhe, kopshte dhe shkolla brenda vitit tonë të parë.
2. Do të nisë ndërtimi i 5 çerdheve të reja brenda mandatit tonë të parë.
3. Do të jenë 8 kopshte të integruara me çerdhe brenda mandatit të parë.
4. Do të ndërtojmë 10 shkolla të reja brenda mandatit të parë.

Takim për turizmin

1. Hartimi i një guide turistike shqip dhe anglisht për ato çka ofron Tirana.
2. Guida dhe harta lëvizjeje për ekskursione ditore ose gjysmëditore.
3. Faqe interneti për promovimin e llojeve të turizmit në Tiranë.
4. Negocimi për hapjen në Tirane të një hoteli, pjesë e rrjetit ndërkombëtar të hotelerisë.

Takim me sportistët

1. Rehabilitimi i palestrave dhe terreneve sportive në të gjitha shkollat e Tiranës.
2. Hapësira sportive në çdo njësi administrative të Tiranës.
3. Partneritet me tifozët dhe ekipin e Tiranës.
4. Mbështetje për të gjitha klubet që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë.
5. Në vitin e parë do të dyfishohet fondi për sportin në buxhetin e Bashkisë.
6. Dyfishimi i hapësirave sportive për çdo 100 mijë banorë (brenda vitit të parë)
7. 90 ambjente të reja sportive në hapësirat e lira brenda pallateve.
8. Për 4 vjet, krijimi i 40 ambjenteve sportive për 100 mijë banorë.
9. Rikonstruktion i të gjitha ambjenteve sportive në pronësi të bashkisë.

Takim në Zallbatar

1. Duhet patjetër të shtrojmë 3.5 km rrugë për t'u lidhur me Rrugën e Arbrit.
2. Në hyrje të Tiranës, nga rruga e Dibrës do të kemi një treg për të gjithë produktet e zonës.

Takim, Njësia Nr.6

1. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, do të ndërtojmë një qendër shëndetësore në Yzberisht.
2. Rikonstruktion në shkollën “Lasgush Poradeci” dhe kopshtet 21 dhe 34.
3. Do të ndërtojmë një kopësht dhe një shkolle 9-vjeçare të re në zonën e Unazës së Re, pranë KMY-së në Yzberisht.
4. Rikonstruktimi i fushës së sportit në qendër të Kombinatit, që është 18 mije metra katrorë.

Veliaj për kujdesin social

1. Do të hapim 3 menca sociale për të ofruar ushqim falas për shtresat në nevojë.
2. Do të çelen 5 qendra ditore për të moshuarit.
3. Program riintegrimi social.
4. Garantim i aksesit në institucionet publike në Tiranë për persona me aftësi të kufizuara.
5. Program për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve në rrugë.

6. Brenda 100 ditëve të para shpërndarja e të gjitha banesave sociale (385 të tilla).
7. Hartimi i një politike për strehim social.

Takim në Njësinë Nr. 2

Do të nisë menjëherë rikonstrukcioni i shumë rrugëve të amortizuara dhe puseta të hapura në këtë njësi, shqetësim për banorët dhe kalimtarët

Takim në Pezë

1. Integrimi rrugor i fshatrave të Pezës me Tiranën.
2. Ndërtimi i rrugës Pezë – Gjysyl Konjë(4km) dhe i rrugës së Varoshit (2 km).
3. Ndërlidhja me transportin publik me Tiranën.
4. Organizimi i tregjeve.
5. Vendosja në punë e sistemit të vaditjes dhe kullimit në territorin e Bashkisë Tiranë.
6. Ngritja e Qendres së Agronomisë dhe Veterinarisë për të orientuar fermeret.
7. Ndërtimi i pikave të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale.
8. Nisma për fermat dhe bizneset agrobujqësore.

Takim në Njësinë Nr.5

1. Do të rehabilitojmë tërësisht kanalizimet në të gjitha lagjet e kësaj njësie të cilat përmbysin rrugët kur bie shi.
2. Pas 21 Qershorit do të ndërpresim menjëherë kontratën me kompaninë e cila nuk kryen pastrimin.

Veliaj për infrastrukturën

1. Rehabilitimi emergjent i të gjitha rrugëve të degraduara.
2. Ndëerhyrje për vënien në funksion të plotë të kanalizimeve për të shpërngur përmbytjet.
3. Pajisje me puseta të të gjitha rrugëve dhe trotuarave të dëmtuara.
4. Rikthimi i hapësirave publike të zëna në mënyrë të paligjshme.
5. Krijimi i hapësirave për transport publik.

Takim në Njësinë Nr. 8

1. Rikonstrukcioni dhe ndërtimi i shumë rrugëve të dëmtuara në këtë njësi.
2. Do t'i shkojmë luftës deri në fund për 60 lejet që Basha dhe S.Berisha dhanë në pragfushatë.

Veliaj për hipotekat

1. Brenda mandatit tonë 385 pallatet dhe 20 mijë familjet do të marrin hipotekën në dorë.
2. Për pallatet e reja, bashkia do të inspektojë punimet.
3. Brenda mandatit të parë të gjitha pallatet do të kenë administrator që lincensohen nga Bashkia

Veliaj për bujqësinë

Bashkia do të ndihmojë me grante të gjithë ata që kanë një projekt mbi kulturat bujqësore.
Për Kopshtin Zoologjik

1. Do ta kthejmë Kopshtin Zoologjik një hapësiëe që Tirana e meriton.
2. Do ta integrojmë me Kopshtin Botanik dhe me Parkun e Liqenit.
3. Do të krijojmë 3 ishuj (Parku i Liqenit – Kopshti Botanik – Kopshti Zoologjik) të lidhur me njëri-tjetrin ku të krijohet hapësira ideale për të kaluar ditën apo fundjavën.

Veliaj për trafikun

1. Do të investojmë për ndërtimin e parkingjeve nëntokësore në partneritete publike dhe private.
2. Do të luftojmë të gjitha lejet e ndërtimit abuzive dhe çdo lloj tenderi që është bërë në fushatë.
3. Audit në Bashki për të gjitha padrejtësitë që kanë ndodhur.
4. Do të rikonceptojmë totalisht linjat e autobusëve në Tiranë, nga 10 linja do ta çojmë në 19-20 linja të reja.

Takim në Njësinë Nr. 1

1. Do të ndërtohet një urë e re në Shkozë e cila nuk do të përmytet
2. Do të zhbllokohen në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak, çerdhja dhe kopshti që janë ne banesat sociale (i kishte bllokuar bashkia).

Veliaj për ndotjen

1. Ndërtimi i një impjanti për përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve.
2. Do të ndalohet rreptësisht djegia e mbeturinave.
3. Do të fillojmë pastrimin nga mbetjet e lumenjve.
4. Ndërtimi i një impjanti modern për përpunimin e ujërave të zeza.

Veliaj për ndërtimet

1. Sa të jem unë kryetar nuk do të ketë leje për ndërtim në Qendren Don Bosko.

2. Nuk do të ketë më leje ndërtimi te Diga e Liqenit

Veliaj me biznesin

1. Nuk do të inkurajojmë ndërtimet në pjeset me dendësi objektesh.
2. Nuk do të ketë më leje të reja ndërtimi pa u shitur apartamentet që janë pa shitur aktualisht.
3. Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë do t'i japim biznesit që është i fokusuar në produktet “MADE in TIRANA”, kaponone me qira 1 euro m².

Takim në Njësinë Nr. 10

Pas 21 Qershorit ne do të çlirojmë parkingjet e uzurpuara pa të drejtë.

Takim në Krrabë

1. Do të synojmë që me kthimin e Krrabës në një zonë atraksioni turistik të qytetit, të rikthehen banorët e vjetër të saj për të ofruar shërbime.
2. Do të bëjmë politika te KM 0, në mënyrë që njerezit nga Tirana të vijnë të blejnë produktet këtu.
3. Përmirësim të transportit publik.
4. Ujësjiellës për fshatrat Mushqeta dhe Skuterrë.
5. Rikonstruksion të disa rrugëve.
6. Ndërtimi i një fushe sporti për të rinjtë në Krrabë.

Takim në Njësinë Nr. 6 (Kashar)

1. Për të gjithë zonën e Unazës së Re ne kemi premtuar ndërtimin e shkollës dhe kopshtit dhe ju do e keni.
2. Qendra Shëndetësore që ju mungon, do të ndërtohet.

Takim në Njësinë Nr.9

1. Në mbledhjen e parë do të merret vendimi për shpërndarjen e banesave sociale.
2. Do të planifikojmë ndërtimin e banesave të tjera sociale sipas nevojave të qytetit.

Takim në Farkë

Është në planin e bashkisë që të ndërhyjmë për të rregulluar infrastrukturën rrugore në të gjithë Farkën.

Veliaj në Njësinë Nr.8

1. Zhbllokimi i të gjithë hapësirave të zëna.
2. S'ka me shitje mallrash në rrugë, do të ketë një treg.
3. Hipoteka për të gjitha pallatet që nuk janë bërë deri tani.

Veliaj në Njësinë Nr.7

Do të fillojmë me rregullimin e 71 rrugëve të amortizuara

Takim në Baldushk

1. Premtojmë sjelljen e ujit në disa zona të Baldushkut.
2. Transport publik në Baldushk.
3. Pastrimi dhe mirëmbajtja e disa rezervuarëve.
4. Do të ndërtohet ura Koçaj-Veski.
5. Hapet segmeti rrugor Koçaj-Veski-Parret-Shënkollë.

Veliaj me veteranët

1. Hapësira publike në çdo lagje.
2. Mund të hapen shtëpi veteranësh, ku sherbehet me kosto shumë të ulët shtypi i ditës dhe kafeja e mëngjesit.
3. Në 24 njësi të kemi 24 partneritete me komunitetin e veteranëve.
4. Bashkëpunim për të pasur një inventar të objekteve personale të veteranëve që kanë nevojë për restaurim.

Veliaj me studentët

1. Do të kemi një fond të bashkisë për nxitjen e punësimit të të rinjve.
2. Do mundësojmë që 1000-1200 të rinj të bëjnë praktikën në bashki.
3. Brenda mandatit të parë do të fillojmë emetimin e Kartës Studentore.
4. Do të anulohen të gjitha kontratat për linjat e transportit publik që janë bërë gjatë fushatës dhe të gjithë abuzuesit do të shkojnë para drejtësisë.

Veliaj në Njësinë Nr.9

Lejet që janë dhënë para moratoriumit do të rishihen të gjitha. Ato që janë për t'u anuluar do të anulohen.

Takim, Dhoma e Tregtisë

1. Krijimi i 3 terminaleve të hyrjes në Tiranë, 3 terminale të transportit publik. Këto mund të bëhen në partneritet me biznesin.
2. Në 100 ditët e para, duam ta krijojmë dhe ta fillojmë Këshillin Ekonomik të Tiranës.
3. S' do të mungoj në asnjë mbledhje të Këshillit Bashkiak.
4. Do të ketë taksa progresive.

Veliaj në Bërzhitë

1. Do të sigurojmë një linjë të mirë transporti për Bërzhitën.
2. Do të përfundojë ujësjellësi në Ibën e sipërme.
3. Rikonstruksioni i digës së Skurranes për të furnizuar me uje për vaditje disa fshatra.
4. Pastroimi i kanaleve vaditese Klllojkë dhe Pëllumbas.
5. Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare Mihajas.
6. Ndërtimi i një qendre shëndetësore në Mihajas.
7. Hapja e rrugës 3.5 km që lidh disa fshatra me rrugën nacionale.

Në stadiumin 'Selman Stërmasi

1. Nuk do të firmos, nuk do të rinovoj asnjë kontratë që i heq copa (llokma) aseteve të klubit Tirana për t'ia dhënë të tretëve.
2. Do të bashkëpunojmë me qeverinë që stadiumi kombëtar të jetë jashtë Tiranës.
3. Do të kenë vëmendjen e duhur edhe impiantet e tjera sportive në qytet.
4. Bashkia do të ndihmojë edhe klubet e tjera që janë në kryeqytet.

Z. Armando Subashi , Bashkia Fier

I rizgjedhur si kryetar i Bashkisë Fier. Gjatë fushatës elektorale u premtoi qytetarëve të bashkisë Fierit respektimin e ligjit dhe të lirisë së qytetarit sipas Kushtetutës së Shqipërisë. Premtimet elektorale ishin të përgjithshme dhe nuk pati një fushatë të rregullt elektorale me premtime dhe informacion tjetër. Ai premtoi zhvillimin e turizmit, bujqësisë.

Z. Fredi Kokoneshi, Bashkia e Divjakës

Shpallja e nje programi te ri ne bashkëpunim me BERZH dhe me bankat e nivelit te dyte duke krijuar mundesine prej rreth 100 mije milion dollore ne vit, që do të jenë në dispozicion të të

gjithë atyre sipërmarrjeve fermere që krijone zinxhirin e vlerës dhe krijojnë rritjen e punësimit. Rilindjen e qendrës së Divjakës, sistemimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse në këtë bashki.

Në fillim të këtij viti Bashkia Divjakë ngriti Drejtorinë e Bujqësisë e cila po merret me këshillimin e orientimin e fermerëve për mbjelljen e kulturave bujqësore, por jo vetëm kaq, kjo drejtori njofton dhe ndihmon të gjithë fermerët që dëshirojnë të aplikojnë për të përfituar nga subvencionet dhe grantet që ofron qeveria qendrore. Bashkia Divjakë ka planifikuar që brenda 4 viteve të pastrohen të gjitha kanalet vaditëse e kulluese

Z. Ndrec Dedaj, Bashkia e Mirditës

Do ketë sistemin e vet të ujësjellësit . Një sistem të ri për grumbullimin e mbetjeve urbane. Këto zgjedhje janë që familjet shqiptare të vendosin për të pasur investime. Një shkollë një kopsht, ujë të pijshëm, kanale të pastruara. Strehimi i një kategorie njerëzore që jetojnë në geto, në rrethinat e qytetit do të jetë një ndër përparësitë e punës time. Për të pasur transportin urban.

Rilindje urbane të kësaj bashkie. Brenda 300 ditëve të para të mandatit tim të gjitha rrugët që shkojnë në qendrat e fshatrave do të jenë të aksesueshme nga automjetet e vogla. Hartimi I nje plani mbi turizmin kulturor dhe për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Mirditës.

Z. Gezim Topçiu, Bashkia e Maliqit

Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vaditjen dhe kullimin në fushën e Maliqit. Do të përmbyllim reformën e veterinarisë. Do të zgjerohet zinxhiri i punësimit. Bashkia e Maliqit, do të jetë laborator i një transformimi të madh. Hartimin e nje strategjie të zhvillimit dhe mbështetjes të sektorit të bujqësisë. Pjesëmarrjes qytetare (konsultim publike,etj) dhe transparencën.

Z. Fatos Tushe, Bashkia e Lushnjës

Ai premtoi përpara banorëve se deri në dhjetorë do të hapen 1600 vende pune në një ndërmarrje fasone, e cila ka nisur punën në qytetin e Lushnjës. Një tjetër premtim i z.Tushe është dhe ai i rikthimit të Universitetit Bujqësor në Lushnjë. Sipas tij, shumë shpejt me mbështetjen e qeverisë, do të nisë punën ndërtimi i një kampusi universitar. Shumë investime në bujqësi dhe infrastrukturë, për të krijuar kushte të favorshme në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e punësimit e të të ardhurave për të gjithë banorët e Lushnjes. Hapja e nje fasonerie në qytetin e Lushnjës që do të plotësojë nevojat e punësimit.

Z. Tërmet Peçi, Bashkia e Tepelenës

Zhvillimin ekonomik te zonës. Do të investojë për ta kthyer Tepelenën në një destinacion turistik. Zgjidhja e problemit të punësimit. Kjo do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit me qeverinë shqiptare dhe me projekte të reja që të përfitojmë nga fondi i nxitjes së punësimit; në planin tim të ardhshëm katër vjeçar është afrimi i bizneseve të mëdha për të hapur këtu, fabrikat e tyre, ndërkohë që bashkia do të krijojë mundësinë për të gjetur objektet se ku do të vendosen. Një repart fason është në proces ku fillimisht do të punësohen rreth 100 persona.

Fokusi kryesor i bashkisë së re do të jetë, menaxhimi dhe administrimi në bashkëpunim me fshatarët e gjithë këtyre zonave, të produkteve të tyre, për ti bërë jo vetëm të konkurrueshëm për tregun vendas, por për të sjellë të ardhura të mjaftueshme për familjet e tyre dhe sigurisht nxitjen e punësimit. Nga ana tjetër nëpërmjet projekteve me ministrinë e Bujqësisë do të punojmë për të vënë në eficensë të plotë gjithë sistemin e vaditjes që është problematike.

Z. Kastriot Gurra, Bashkia e Librazhdit

Do të investohet në rrugë me standarde dhe jo asfalt elektoral siç ka ndodhur gjatë këtyre viteve. Gjithashtu në bashkinë e re, do të krijohet një drejtori për mirëmbajtjen e rrugës. Pasi po aq e rëndësishme është t'i mirëmbash. Ne angazhohemi që brenda vitit të parë të mandatit të bëjmë lidhjen me energji dhe ujë të të gjitha qendrave shëndetësore me qëllim funksionimin normal të tyre. Ashtu sikurse do të bëjmë një evidentim të saktë të gjendjes së shkollave dhe kopshteve. Do të rikonstruktohen rruga Mirakë-Gurëshpatë, Librazhd-Spathar, Librazhd-Babje, Dragostunjë-Veçan. Reformat, investimet apo buxhetet t'i miratojmë në një konsultim të gjerë me publikun për këtë arsye do të bëjmë dëgjesa në çdo lagje të bashkisë së re. Le të jenë ata vetë që të përcaktojnë një radhë investimesh në zonën ku ata banojnë me qëllim që të dëgjohet zëri i qytetarëve. Do të krijohet një drejtori në bashki në funksion të parkut do të bëjë një vlerësim të dëmeve që janë shkaktuar nga mënyra barbare e trajtimit të pyjeve deri më sot. Do të kontrollojmë të gjitha këto leje me shumë rigorozitet dhe kush ka firmosur nga specialistët apo titullarët që kanë përfaqësuar institucionet deri dje.

Përfundimi i rrugës drejt Stëblevës do të jetë një mundësi shumë e mirë për të sjellë turistë ashtu sikurse do të krijojmë një zyrë të posaçme për turizmin për të pasur një guidë, një hartë të të gjithë territorit ku ka shumë vend për të eksploruar mrekullitë e natyrës. Në bashkëpunim me qeverinë do të vendosim nëse do të ndërtojmë landfill apo do t'i kalojmë në Elbasan edhe në bashkëpunim me marrëveshje me kryetarin e ri të bashkisë Elbasan.

Do të heqim dorë nga mënyra e administrimit që ka ndodhur deri tani, ku fshatra të tërë ngeleshin të bllokuar nga bora me muaj. Me ndërmarrjen e re të mirëmbajtjes së rrugëve që do kemi në bashki do të marrim masa që situata të tilla të mos përsëriten më. Do të marrim masa

edhe me biznesin e atyre zonave, sepse bora bie njëherë për të gjithë dhe është e pamundur që të hapen të gjitha rrugët njëherësh por ne në bashkëpunim me biznesin do të marrim masat që të mos ketë asnjë rrugë të bllokuar gjatë dimrit. Do të shtojmë bursat për të siguruar arsimin e fëmijëve të këtij komuniteti. Do të ofrojmë kushte me kredi lehtësuese për të siguruar strehim për familjet që kanë vështirësi për strehim.

Sa i takon ndihmës ekonomike është rritur masa e saj. Për shkak të terrenit së bashkisë Librazhd nëpërmjet financimeve dhe nxitjes në blegtori ne do të arrijmë të dyfishojmë dhe të trefishojmë numrin e krerëve të bagëtive të imta në bashkinë e madhe. Do të krijojmë pika grumbullimi në bashki edhe dhoma frigoriferike të cilat do të jenë një mundësi shumë e mirë për banorët që produktet t'i shesin dhe të mos ju ngelet stok.

Z. Arif Tafani, Bashkia e Belshit

Përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Belshit. Objektiv kryesor në fillimin e mandatit do të jetë ngritja e bordeve qytetare. Konsultimi me publikun për buxhetimin, planifikimin e territorit, për përcaktimin e radhës së investimeve do të jenë parimet e mia për të përfshirë komunitetin në vendimmarrje. Zgjidhja përfundimisht e problemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Hartimi i projekteve mbi infrastrukturën rurale, veçanërisht garantimit të ujit për vaditje dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese. Fuqizimin dhe zgjerimin e shoqatës së duhanit, asistencën me specialistët e bashkisë dhe të studiove të specializuara në lidhjen e kontratave me fermerët, pasi këtu fillon hileja e subjektit që grumbullon duhanin e zonës, duke punuar fort për të bindur fermerët për nënshkrimin e kontratës kolektive me shoqatën, pasi kështu të drejtat e prodhuesit mbrohen më mirë e më me forcë.

Ndërtimin e tregut bujqësor në Belsh, ndërtimin e një frigoriferi të madh për ruajtjen e prodhimeve deri në shitje, ngritjen e shoqatave të tjera si dhe vreshtarëve, ullirit, blegtoreve, etj. Nxitjen e tyre që brenda kuadrit ligjor të veprojnë edhe si subjekte tregtare në sigurimin e inputeve bujqësore, farërave, fidanëve, pesticideve, plehrave, të mekanikes bujqësore, etj. Do të jem avokat mbrojtës i fermerëve pranë qeverisë dhe institucioneve të tjera për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre.

Do të fus për herë të parë shërbimin e tërheqjes së mbetjeve urbane dhe mirë-menaxhimin e tyre në të gjithë territorin e bashkisë Belsh, shërbim i cili sot mungon.

Z. Ervin Demo, Bashkia e Beratit

Ervin Demo, kandidati i Partisë Socialiste, për kryetar të bashkisë Berat, është shprehur se “do të bëjë realitet një program konkret zhvillimi për qytetin e Beratit, me investime në infrastrukturë dhe shërbime, që do të rikthejnë besimin e qytetarëve tek pushteti vendor dhe do të kthejnë qytetin në një destinacion të preferuar turistik.

Në mandatin e parë për drejtimin e bashkisë Berat, do të punoj për zgjatjen e sezonit turistik që do të thotë më shumë të ardhura për qytetarët. Ne jemi për një fshat që prodhon më shumë, për integrimin e të rinjve në tregun e punës dhe zhvillimin e vendit dhe për ta kthyer Beratit në destinacion të turizmit dhe përdorimin e vlefshëm të aseteve e pasurive natyrore në të ardhura ekonomike. Pjesë e projektit tim është edhe bypass-i i qytetit një ëndërr e qytetit prej dekadash” – tha z. Demo.

Z. Lifter Alla, Bashkia e Bulqizës

Bulqizës i duhet rikthyer vëmendja e munguar gjatë gjithë këtyre viteve. Ky është momenti për nxitur investimet në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, turizëm, bujqësi etj. Bulqiza është një krahinë që gëzon shumë mundësi të cilat duhet të shfrytëzohen për të rritur mirëqenien e banorëve të saj. Sipas tij, katër vitet e ardhshme do të shënojnë mbylljen e kanalizimeve të ujërave të zeza, përfundimin e fazës së dytë të kanaleve vaditëse, zgjidhjen e problemit të transportit të nxënësve, si edhe ndërtimin e një fabrike për përpunimin e produkteve të qumështit në një zonë.

Z. Ardian Gurma, Bashkia e Sarandës

Kandidati thekson se qyteti ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit. Ardian Gurma: “Bashkia e Sarandës do të jetë në krye të të gjitha bashkive turistike të vendit sepse edhe potencialet për evoluim e zhvillim janë të mëdha”. Janë programuar mbi 10 milion euro investime për shëtitoren e re dhe nuk besoj se është shifër e vogël. Është programuar investim për infrastrukturën brenda pallateve. Edhe në takimet e bëra bashkë gjatë ditëve të fundit kam vënë re se ka nevojë për ndërhyrje.

Në 4 vitet e ardhshme do ta kemi në fokus Ksamilin. Dua tu kërkoj me sinjeritet dhe çiltërsi të më jepni votën në 30 Qershor dhe do tua kthej këtë votë në shërbim ndaj jush. Nuk themi se do të bëjmë mrekullira por ju garantoj se Ksamili në 4 vitet e ardhshme do të jetë shumë më mirë se sot”, u shpreh z. Gurma.

Z. Andis Salla, Bashkia e Cërrikut

Kandidati për kryetar bashkie në Cërrik Andis Salla, ka zhvilluar atje një aktivitet me të rinjtë e qytetit. “Pjesëmarrja masive e të rinjve është përgjigja më e mirë për të gjithë ata që dyshojnë tek 30 Qershori. Në 30 Qershor të rinjtë e Cërrikut votojnë së pari për të ardhmen e tyre”, theksoi kandidati Salla. “Natyra fantastike dhe pozicioni gjeografik e bëjnë këtë liqen, një destinacion të vërtetë turistik. Investimet do jenë kryefjalë e punës sime”, theksoi ai.

Zj. Majlinda Qilimi, Bashkia e Delvinës

Dua që këtë qendër (të rilindjes urbane) ta rivitalizoj duke shtuar hapësirat e gjelbra, duke vendosur më shumë stola dhe kënde për fëmijë, por edhe duke e kthyer në shërbim të biznesit. Më pas do të shtrihemi në të gjitha rrugët e qytetit dhe te ato që lidhin fshatin me qytetin”, tha znj. Qilimi.

Kandidatja socialiste ka një alternativë edhe për zhvillimin turistik të zonës. “Delvina ka vlera të lashta historike, që në mesjetë ka qënë sanxhak dhe qendër shumë e dëgjuar. Fatkeqësisht sot i mungon një muze dhe unë do ta filloj nga muzeu që do të marrë jetë shumë shpejt. Ristrukturimi i tij do t’i shërbejë turizmit në zonë, duke u ndërthurur edhe me resurset natyrore që zona jonë ka”, theksoi Qilimi. Ajo premtoi edhe ngritjen e një qendre sociale të përkujdesjes për shtresat dhe komunitetet më në nevojë të Delvinës.

Z. Eduart Duro, Bashkia e Devollit

Do vendos në shërbimin tuaj gjithë potencialin tim për të ndryshuar bashkinë e Devollit dhe për t’ia kthyer atë devollinje; Projekte dhe plane konkrete veçanërisht për bujqësinë, pasi është në gjendje kaotike; Plane konkrete edhe për turizmin. Ka shumë për të bërë, ka shumë vende historike, pozicioni gjeografik është i tillë që na favorizon si në hyrje ashtu dhe në dalje të Shqipërisë. Rritjen e mirëqenies për çdo familje, që të rinj dhe të reja të mos mbajnë sytë jashtë por të ushtrojnë profesionin e tyre, aftësitë dhe dijenitë e tyre t’i vënë në shërbim, aty në fshatin e lindjes, në krahinën e bukur të Devollit;

Projekte konkrete për aktivitetet sportive në të gjitha llojet e sporteve; Do punojmë së bashku për të bërë më të mirën për komunitetin tonë në çdo cep të Devollit.

Z. Dionis Imeraj, Bashkia e Dibrës

Rikonstruksioni i plotë i qendrës rekreative për moshën e tretë dhe hartimi i planeve specifike, do përmirësojnë jetesën aty. Brenda vitit të parë të punës sime si kryetar i Bashkisë Dibrë do të realizojmë rikonstruksionin e argjinaturës së liqenit të Gramës, në mënyrë që furnizimi me ujin vaditës për banorët e fshatrave që mbulon ky burim të mos ndërpritet. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse, për të përballuar më së miri vaditjen e tokave bujqësore. Furnizimi me ujë të pijshëm në çdo shtëpi në fshatrat ku mungon. Asfaltimi i rrugëve në brendësi të fshatrave për Njësinë Administrative Kastriot. Sepse vetëm së bashku mund të udhëtojmë të sigurtë drejt zhvillimit në çdo fshat dhe në çdo zone. Çdo kërkesë e tyre do të adresohet e shqyrtohet me të marrë mandatin e kryebashkiakut.

Z. Dhimitraq Toli, Bashkia e Dropullit

Slogani ynë elektorale është “Një fillim i ri për Dropullin dhe Pogonin tonë”. Unë, së bashku me kandidatët për këshilltarë bashkiakë do realizojmë disa objektiva që kanë në fokus shndërrimin e zonës tonë në një bashki model”, – tha Toli. problemi kryesor këtu është uji i pijshëm, me investimet nga bashkia ne do krijojmë mundësinë që në bashkinë tonë uji të jetë 24 orë.

Një problem tjetër që kërkon zgjidhje imediate është certifikimi i pasurisë së paluajtshme dhe ne do krijojmë mundësitë që të ndihmojmë qytetarët tanë për zgjidhjen e kësaj çështje”. “Gjithashtu do rrisim përqindjen e buxhetit për arsimin me qëllim që fëmijëve tanë ti plotësojmë të gjitha kushtet. Sigurisht do përmirësojmë dhe infrastrukturën rrugore. Mjeku i familjes do jetë në dispozicionin e gjithë banorëve të Dropullit”. Një pikë tjetër e rëndësishme është organizmi i fermerëve në shoqata dhe grumbullimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale, certifikimi i tyre dhe krijimi i mundësive që këto produkte të dalin nëpër tregje.

Zj. Valbona Sako, Bashkia e Durrësit. Ka dhënë dorëheqje. Për momentin bashkia e Durrësit nuk ka një kryetar të zgjedhur.

Takimi në terren i sa më shumë banorëve të Durrësit, për të kuptuar cilat janë problematikat dhe zgjidhjet më të mira. Njëkohësisht në funksion të vizionit për një mbështetje të fuqishme për rininë, krijimi i një fushate dhe një axhende rinore, ku nëpërmjet dialogut me ta, do të piketojmë dhe mënyrat e mundshme për angazhimin e tyre.

Pesë prioritetet kyçe në program;

- Rritja e transparencës dhe aksesueshmërisë në shërbimet që do ofrojë Bashkia e Durrësit

- Fuqizimi i rinisë dhe grave
- Krijimi i sa më shumë hapësirave të gjelbra
- Vëmendje e shtuar nga zonave periferike dhe rurale
- Investim dhe bashkëpunim nga ana e Bashkisë së Durrësit për projekte të rëndësishme turistike dhe kulturore.

Z. Gledian Llatja, Bashkia e Elbasanit

- Elbasani do të ketë përmasat e një qyteti me standarde europiane dhe do të vazhdojë me ritmin e transformimeve si dhe në adresimin e çdo problematike të qytetarëve;
- Bashkia Elbasan do të jetë edhe më afër fermerëve dhe blegtorëve për ti dhënë një tjetër ritëm zhvillimit rural të zonës;
- Fëmijët do të jenë prioritet i Bashkisë Elbasan, për t'i dhënë atyre një qytet me standarde europiane.

Z. Kristo Kiço, Bashkia e Finiqit

- Do ta bëjmë bashkinë e Finiqit një bashki model siç janë qytetarët e kësaj zone dhe minoritarët që janë pjesë përbërëse e saj;
- Në këtë zonë ndodhen afërsisht rreth 60 fshatra, tre gjëra do t'i sigurojë fshatrave të këtij minoriteti, rrugë, ujë dhe energji elektrike, gjërat bazë të një jetese normale;
- Do të zgjidhim problemin e pronave, t'i kthejmë qytetarëve titullin e pronësisë për të bërë të mundur lënien në breza trashëgiminë e tyre;
- Do të merremi me arsimin, një nga arsyet që njerëzit ikin dhe lënë shtëpitë dhe familjet e tyre, dhe ne e kemi për detyrë për t'i krijuar atyre kushte që këta fëmijë të arsimohen këtu, në këtë zonë;
- Duhet të marrim masa për sigurimin e mbrojtjes e rendit sigurisë në këtë vend pasi është një zonë shumë e hapur me shumë rrugë dhe që duhet të krijojmë kujdes duke e rritur përbërjen e stacionit policor i cili ndodhet në Livadhja, ne do të kthejmë drejtësinë e munguar;
- Ndërtimi i Aeroportit të Sarandës;
- Kjo bashki do të jetë dora e ngrohtë e çdo pensionisti si dhe çdo familje e cila ndodhet në zonën e Finiqit.

Z. Fran Tuçi, Bashkia e Fushë – Arrëzit (ri-kandidim)

- Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe zhvendosja e rrjetit të amortizuar të ujësjetllësit që do rezultojë në rritjen e mbledhjes së ujit të pijshëm në rezervuarët respektiv.
- Rilindja urbane e Fushë Arrëzit
- Rritja ekonomike me 5%;
- Do të kryhet furnizimi me ujë të pijshëm brenda standardeve në gjithë zonën
- Do të krijohet një klimë bashkëpunimi mes bashkisë dhe institucioneve të tjera, si arsimit, shëndetësia dhe energjetika;
- Do të shtohen hapësirat çlodhëse në territorin e bashkisë
- Do të kryhet mbështetja e sportit duke financuar ekipet e të rinjve, në futboll por edhe në lojërat e tjera me dorë, alpinizmi dhe sportet dimërore
- Do të krijohet një fond dhe do të kryhet promovim i grupit folklorik të moshave të vogla për të ruajtur traditën dhe identitetin
- Do të kryhet binjakëzim me qytete të tjera jashtë Shqipërisë
- Do të krijohet një bibliotekë për qytetin, me donacione
- Do të krijohet një fond për nxënësit me rezultate të larta
- Do të organizohen më shumë aktivitete kulturore
- Do të shtohen hapësirat sportive në territorin e bashkisë
- Do të kthehen në traditë ditët gjeçoviane në fshatin Kryezi
- Do të kryhet sistemimi dhe përpunimi i mbetjeve në territorin e bashkisë
- Do të kryhet rikthimi i hapësirave të gjelbra të qytetit
- Do të kryhet kthimi në zonë të mbrojtur për Munellën dhe më pas kthimi i saj në zonë turistike
- Do të kryhet zhvillimi i turizmit shëndetësor
- Do të kryhet zhvillimi i turizmit malor
- Do të kryhet menaxhim në mënyrë profesionale të bimëve medicinale
- Do të ngrihet grup pune për çdo fshat për të evidentuar problemet dhe për të eliminuar konfliktet sociale
- Në tremujorin e parë pas zgjedhjeve do të organizohet takimi me përfaqësuesit nga të gjitha zonat për rezultatet e arritura
- Do të ketë transparencë për të ardhurat që jep shteti për familjet e varfra, PAK dhe jetimë;
- Do të kryhet bashkëpunim me organizatat joqeveritare, institucionet e bamirësisë, për të përmirësuar kushtet e familjeve në nevojë.

Z. Klodian Taçe, Bashkia e Gramshit

Nje nga premtimet e kandidatit per kryetar bashkie ne Gramsh ishte prishja e HEC qe po ndertohet ne kanionet e Holtes.

Z. Flamur Golemi, Bashkia e Gjirokastrës

Golemi u shpreh se eshte jam gati të punoj për Gjirokastrën dhe të shërbej si kryebashkiak me përkushtimin e një mjeku dhe dhembshurinë e një babai që dy djemtë e tij ka vendosur t'i rrisë në këtë qytet. “Nuk kemi më kohë për të humbur, së bashku kemi projekte për Gjirokastrën duke filluar që nga Sheshi i Çerçizit, parkingu nëntokësor, pallati i sportit, terminali i autobusëve etj. Këto janë disa nga projektet, pasi do ketë dhe shumë të tjerë që do të vazhdojnë me mbështetjen e qeverisë gjatë 4 viteve të ardhshme”, – përfundoi kandidati i Partisë Socialiste për bashkinë Gjirokastrë, Flamur Golemi.

Z. Liman Morina, Bashkia e Hasit

Prioritet ndërtimi i rrugës që lidhë njësitet administrative me rrugën Nacionale. Ndërtimi i shkollave dhe rikonstrukcioni i atyre egzistuese.

Z. Jorgo Goro, Bashkia e Himarës

Në 4 vitet e ardhshme do të çohen përpara investime të reja. “Ka nisur puna për ujësjellësin dhe ky është një investim i madh që zgjidh përfundimisht dhe çështjen e kanalizimeve”. Do vazhdojmë të ndryshojmë infrastrukturën turistike si për ujin, ashtu sikurse me sheshet dhe shëtitoret siç është ajo e Borshit. Gjithashtu lidhja e gjithë Bashkisë dhe njësive të saj përmes Rrugës së Lumit të Vlorës. Do realizojmë atë që kemi premtuar, Bashkinë më të mirë turistike të Shqipërisë dhe zemrën e turizmit shqiptar.

Z. Rakip Suli, Bashkia e Kamzës

Rakip Suli iu bëri me dije banorëve se vëmendja imediate përgjatë qeverisjes lokale të bashkisë Kamëz, në këtë zonë, për 4 vitet e ardhshme, do të drejtohet menjëherë në përmirësimin imediat të infrastrukturës në zonë, ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve si një nevojë e madhe për të vegjlit. Gjithashtu Suli u shpreh se gjithashtu do punohet dhe në projektimin dhe ndërtimin e

hapësirave rekreative, këndeve të lojërave dhe mjediseve çlodhëse, pastrimin dhe trajtimin e mbetjeve për një jetesë kualitative dhe të shëndetshme.

Z. Redjan Krali, Bashkia e Kavajës

Zonat rurale janë pa ndriçim, me rrugë të rëndomta dhe pa ujë të pijshëm. Në këto dy vite asnjë premtim nuk u mbajt për këto banorë dhe akoma më keq as mbeturinat në koshat e plehrave nuk pastrohen. Gjate mandatit 4 vjecar do sistemojme kanalet kulluese dhe vaditese, do te kemi projekte per vitalizimin e zones urbane duke sistemuar infrastrukturen dhe duke permiresuar sistemin e ujit te pijshem.

Z. Klement Ndoni, Bashkia e Këlcyrës (mandati i tretë)

Nuk janë zhvilluar takime pasi është kandidimi i tretë i tij. Gjatë vitit të fundit ka pasur shumë përplasje me banorët e zonës së Këlcyrës për prishjen e 30 objekteve në qytet për rilindjen urbane (ndërtimi i një pedonale).

Z. Imi Hoxha, Bashkia e Klosit

Theksoi, se ai do të jetë në funksion të zgjidhjes së halleve dhe problemeve të qytetarëve, duke shtuar gjithashtu se prioritet do të jetë zhvillimi i zonës së bashkisë së Klosit. Do t'ju dëgjoj me vëmendje nga çdo cep i bashkisë së Klosit për të çuar përpara projektet e së ardhmes të bashkisë që duam, e cila do jetë tërësish në funksion të komunitetit, të nevojave dhe pritshmërive të secilit prej jush. Unë dhe ekipi im kemi qenë të qartë dhe do të bëjmë gjithçka pasi të më besoni drejtimin e bashkisë së Klosit, por jam i sigurt që suksesi i qeverisjes sonë vërehet nga kontributi i secilit prej jush.

Z. Erion Isaj, Bashkia e Kolonjës

- Të gjithë qarkun ta zgjojmë dhe ta bëjmë Kolonjën të vizitueshme e të aksesueshme për turizmin dhe agroturizmin;
- Kënd lojërash për fëmijët në Ersekë dhe Leskovik;
- Strehë sociale për njerëzit e pamundur dhe vend ku të mblidhen të moshuarit për të biseduar dhe për të kaluar ditën.
- Shkolla dinjitoze;

Për fshatin Rehovë:

- Ujësjiellës i ri;
- Restaurimi i 80 portave të fshatit;
- Subvencionimi i ngritjes së bujtinave;
- Rikualifikimi urban i qendrës së fshatit;
- Kalldrëme të reja;
- Rehabilitimi i rrugës që të çon për në Rehovë.

Për fshatin Borovë:

- Ujësjiellës i ri;
- Rehabilitimi i urës së Totës;
- Kalldrëme të reja;
- Rikualifikimi urban;
- Vënia në funksion e Muzeut të Masakrës (Muzeu i Borovës);

Për fshatin Barmash:

- Ndërtimi i rrjetit të brendshëm të ujësjiellës;
- Projekte të reja në shërbim të komunitetit të kësaj zone;

Për Leskovikun:

- Ujësjiellës i ri;
- Rehabilitimi i rrugës Ersekë-Leskovik;
- Rehabilitimi i rrugës së llixhave të Sarandaporit;
- Ta kthejmë Leskovikun në atraksionin turistik më të frekuentuar nga turistët vendas dhe të huaj.

Për fshatin Selenicë:

- Ujësjiellës i ri;
- Rehabilitimi i kanaleve vaditëse;
- Subvencionet për fermerët;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve.

Për Njësinë Administrative Mollas:

- Ujësjiellës i ri;
- Rikualifikimi urban i qendrës Mollas.

Z. Shuaip Beqiri, Bashkia e Konispolit

Beqiri premtoi më tepër investime dhe shërbime më të mira për banorët e Konsipolit, gjatë mandatit të dytë. Duke përmendur dhe ndertimin e aeroportin ne Sarande qe do te sjelle ndryshimin ne zonat e Sarandes- Konispolit- Finiqit.

Z. Artur Bushi, Bashkia e Krujës

Bushi është shprehur se për Krujën gjend vend shprehja “Nuk keni parë gjë akoma”, me projektet e reja që do që do të nisin”. Jatë takimit me banorët u diskutua për pjesën e dytë të transformimit të qytetit, ku përfshihen investimi i Ujësjiellësit.

Rruga Krujë- Fushë Krujë, Poliklinika e Krujës, të cilat janë vetëm investimet e para në mandatin e dytë të Bushit. Bushi gjithashtu në njëzetë takim theksoi se, një nga investimet më të rëndësishme që është bërë në Bashkinë Krujë është rrjeti i ri elektrik. “Ishte një “gangrenë” 30 vjeçare, të cilës po i jepet zgjidhje si në Dukagjin ashtu dhe në fshatrat e tjerë të kësaj bashkie”, tha Bushi.

Z. Kreshnik Hajdari, Bashkia e Kuçovës

Ka pohuar se, edhe pse e presin shumë sfida të vështira që duan mund dhe durim të madh, ato do të realizohen me përkushtim nga ana e tij. Kreshniku ka premtuar se do trajtoj me respekt maksimal kritikën dhe alternativat që do i parashtrohen. Pas 30 qershorit, reformim i thellë i administratës, reformim teresor i mënyrës së të punuarit. Zyrat e bashkisë do të jenë zyrat e qytetarëve, punonjësit e bashkisë në shërbim të qytetarëve. Bashkia e re do të ofrojë projekte dhe politika stimuluese për biznesin, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe një rritje të punësimit. Natyrisht që kemi edhe objektivat e përmirësimit të infrastrukturës.

Me rëndësi është ndërtimi i rrugës Kuçovë - Lumas, sepse lumasi edhe pse pas reformës territoriale iu bashkua bashkisë kuçovë akoma nuk e ka një rrugë që të lidhet me Kuçovën. Do të fillojmë menjëherë nga projektet, dhe me të ardhurat e bashkisë apo me ndihmën e qeverisë do të

bëjmë të mundur realizimin e tyre. Të gjitha këtyre, do t'i shtohet një prej investimeve më të mëdha në Shqipëri, të realizuara vetëm falë ndërmjetësimit të qeverisë socialiste, rihapja e aeroportit të Kuçovës, si një bazë moderne e NATO-s, çka do të krijojë punësim dhe do të gjallërojë të gjithë ekonominë lokale.

Z. Safet Gjici, Bashkia e Kukësit

Objektivat:

- Përmirësimin e efikasitetit të përgjithshme të strukturave të qeverisjes vendore të Bashkisë dhe Njësive Administrative
- Përmirësimin e shërbimeve në të gjitha nivelet
- Forcimin e Mirë-Qeverisjes në bashkëpunim me qytetarët
- Përmirësimin e infrastrukturës
- Rritjen e punësimit
- Mënyrat si do të realizohen
- Për çdo fshat apo lagje të Bashkisë Kukës do të ketë 2 punonjës shërbimi (me logon e Bashkisë Kukës), të cilët do merren me të gjitha shërbimet: pastrim rrugësh, kanalesh, grumbullim mbetjesh, sistemim teritosh, etj.
- Për çdo fshat dhe lagje do të përcaktohet që në fillim të vitit sa fond do I vihet në dispozicion për shërbime dhe sa për investime.
- Investimet për fshatrat dhe lagjet do të përcaktohen nga vetë Komuniteti (jo administrata e bashkisë).
- Do të rritet vlera e investimeve, nga 13 % që është aktualisht në 70% të vlerës së buxhetit të bashkisë.
- Do të ngrihet portali “ kukësiqëduam.al ”.
- Do të krijohet modeli i vlerësimit të punës së bashkisë, ku qytetarët të japin mendimin e tyre çdo vit për çdo shërbim që ato do të marrin nga bashkia. Do të bashkëpunohet ngushtë me shoqërinë civile për vlerësim të pavarur.

- Do të nxitet krijimi i bizneseve të reja në artizanat, peshkim, bujqësi, bimë mjeksore, fasoneri, turizëm. Bashkia do të ndajë në buxhet fonde të veçanta për të rinjtë dhe do të bashkëpunojë me donatorët.

Zj. Majlinda Cara, Bashkia e Kurbinit

Rilindja urbane do shtrihet edhe në njësitë Mamurras, Milot, Fushë Kuqan. Projektet e mia janë afatmesme dhe afatgjata. Në investimet emergjente përfshij rehabilitimin e përroit të kanailit që përshkon gjithë qytetin e Laçit.

Investim emergjent në ndihmë të komunitetit është rehabilitimi ujësjellësit. Një investim që duhet bërë patjetër për ta bërë më të lehtë jetesën e banorëve”. Lidhur me bujqësinë, Cara tha “do të bëjmë ndërhyrje emergjente për pastrimin e të gjitha kanaleve kulluese dhe hapjen e kanaleve të reja vaditëse në mënyrë që banorët ta kenë më të lehtë zhvillimin e bujqësisë”

Z. Pjerin Ndreu, Bashkia e Lezhës

Lezha ka shumë potencial, është fenomen turistik dhe në kulinari. Ne do të marrim në dorë qytetin, do e ridizenjojmë dhe do bëjmë një ndryshim radikal, edhe në njësitë administrative ku investimet janë në nivelin zero. Ndreu theksoi se “të gjithë janë dakord se në Lezhë nuk është punuar, duhet ndërtuar një histori e re, sepse askund më shumë se në Lezhë nevoja e ndryshimit nuk shihet. Ajo që është e qartë, ne kemi marrë mbështetje për të ndërhyrë në këtë gjendje skandaloze, me njerëz që paguhen në bashki, por jetojnë jashtë shtetit”. Plani im emergjent, vijoi ai, është vendosja e një strukture të re funksionale në bashki, ku duhet rikompozuar mënyra e të vepruarit dhe komunikuarit me njerëzit. “Duhet një politikë shumë agresive me mirëmenaxhimin e fondeve. Aty ka probleme me ujësjellës, kanale që nuk janë prekur fare. Bashkia është një godinë që nuk pret njerëz, nuk zgjidh problem të banorëve. Ne do të ndërtojmë një bashki ku çdo njeri do të ketë detyrën t’i përgjigjet qytetarëve”.

Zj. Luiza Mandi, Bashkia e Libohovës

Mandi ka thënë se, “kemi ndryshuar faqen e qytetit të Libohovës dhe kemi ndërtuar aty një pëdonale fantastike. Gjithashtu janë bërë investime në infrastrukturën rrugore, në bujqësi. Të gjitha këto investime janë kryer gjatë 4 viteve të fundit si kurrë më parë, të cilat ishin harruar prej 24 vitesh nga qeverisja e mëparshme”. “Ne kemi nevojë akoma për më shumë investime, pasi janë deficitet e viteve të tëra që nuk mund të mbulohen me këtë 4-vjeçar. Janë investime për ujësjellësin, për rrugën e Zagorisë dhe një sërë investimesh të tjera”,

Z. Tonin Marinaj, Bashkia e Malësisë së Madhe

Ka premtuar se vemendja kryesore do të jete për zgjidhjen e problemeve që ato I shqeteson siç është furnizimi me ujë dhe investimet në infrastrukturë. Unë gjatë këtyre katër viteve jam përpjekur të bëj në çdo cep të M.Madhe më të mirën e mundshme”

Z. Qerim Ismailaj, Bashkia e Mallakastrës

Investimet në infrastrukturë në çdo njësi administrative të Bashkisë Mallakastër do të jenë prioritet të kësaj 4 vjeçari. Në bashkëpunim me qeverinë qendrore do realizojmë marrje të shumta projekteve të cilat do bëjnë të mundur uljen e papunësisë.

Z. Agron Malaj, Bashkia e Matit

Kandidati Malaj u shpreh se ndjente keqardhje që për 28 vjet në rrethin e Matit nuk është treguar kujdesi i duhur për rininë. Ai garantoj të rinjtë e Matit se ka një program të qartë mbështetjeje për rininë. Ish-futbollistë, trajnerë dhe mbështetës të sporteve në qytetin verilindor thanë se për vite me radhë pushteti lokal ka treguar kujdes shumë të pakët për sportet. Po ashtu gjendja e terrëneve sportive është kritike dhe se ajo duhet ndryshuar sa më shpejt. Kandidati Malaj premtoi se ai do të tregojë vëmendje të veçantë për ndryshimin e situatës aspak normale.

- Ndërtime në infrastrukturë;
- Rikonstrukcioni e dy blloqeve, duke i kthyer ato në ambiente funksionale.
- Sigurimi i ndriçimit
- Mjedisë shpëldhëse.
- Mundësi punësimi

Z. Gjolek Guci, Bashkia e Memaliajt

Guci tha se, “falë takimeve derë më derë me banorët në tashmë kemi një panoramë më të qartë dhe reale të problematikave të zonës së Memaliajt. Ne jemi realistë që kërkesat e zonës nuk i plotësojmë dot të gjitha, por ju garantojmë që vullneti dhe dëshira e ekipit tonë për të punuar për zhvillimin e kësaj zone nuk do mungojë kurrë”. “Ne do ta nisim punën tonë me ndërhyrje në infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësat, që janë jetike për zhvillimin e zonës. Gjithashtu do

punojmë fort për të krijuar vende të reja pune për bashkinë e Memaliajt dhe gjithë qytetit”, – tha Guci. “Si inxhinier ndërtimi që jam, kam bindjen që së bashku me skuadrën e Memaliajt do bëjmë më të mirën për shumë projekte që kemi nisur dhe për ato që do nisim së shpejti”, – përfundoi Guci.

Zj. Rajmonda Balilaj, Bashkia e Patosit (rikandidim për herë të tretë)

Në kuadër të Rilindjes Urbane, Patosi ka përfituar rivitalizimin e qendrës, ose rrugës lineare dhe shëtitoren ‘Republika’, pra janë 2 km të zhvilluara. Patosi ka sot një shëtitore krejtësisht të transformuar. Kjo lidhet me unazën e qytetit, një tjetër investim i rëndësishëm.

Dy projekte të rëndësishme janë realizimi i rrugëve me standarde urbane në dy nga njësitë tona administrative”. Sa i takon zhvillimit bujqësor, Balilaj tha se “është kryer 70% e rehabilitimit të të gjithë infrastrukturës së bujqësisë, gjë që ka bërë që shumë fermë t’i kthehen tokës dhe të shtohet numri i serrave”. Duke folur për prioritetet e mandatit të tretë ajo tha se “në mënyrë të veçantë do të punohet në drejtim të furnizimit me ujë të pijshëm të gjithë territorit”. “Kjo është një nga sfidat që do kemi përballë. Kemi arritur të hartojmë fizibilitetin dhe projektin e këtij shërbimi. Tani duhet të gjejmë financimet dhe të fillojmë investimin. Infrastruktura në zhvillimin e blloqeve të pallateve është një tjetër drejtim. Jemi gati që t’i fillojmë shumë shpejt. Hartimi i planit të përgjithshëm vendor hap perspektiva të reja për të gjithë territorin e bashkisë. Por edhe ndërtimi i qendrave urbane të njësive administrative do të jetë shumë shpejt i prekshëm”

Z. Lorenc Tosku, Bashkia e Peqinit

Kryebashkiaku i ri i Peqinit pas ceremonisë së betimit, shprehu angazhimin se në rrugëtimin e qeverisjes së kësaj bashkie në katër vitet e ardhshme, do të bëjë gjithçka të mirë të mundshme që jeta e çdo familje në zonën urbane dhe ato rurale ta ndjejë më shumë se çdo herë tjetër

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve;
- Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës;
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe çdo aspekti tjetër të jetës si në aspektin arsimor, social, kulturor, shëndetësor, ekonomik, sportiv etj.
- Në 4 vjeçarin e ardhshëm do të kemi më shumë investime në zonë dhe më shumë zhvillim.

Zj. Alma Hoxha, Bashkia e Përmetit

“Unë dua t’i jap një fytyrë tjetër mënyrës së administrimit të bashkisë, duke filluar që nga komunikimi me qytetarët. Pas 30 Qershorit do të jetë një bashki shërbimesh, ku qytetari do të jetë i pari”. “Në Përmet është bërë shumë sa i takon infrastrukturës së qytetit, është bërë investim i madh i ujësjellësit të qytetit dhe në kulturë e trashëgimi nga qeveria. Por ajo që më dhemb më shumë është se infrastruktura rurale, që lë për të dëshiruar. Rrugë të munguara, kanalizimet, vaditja, uji i pijshëm mungojnë. Investimet që janë bërë nga pushteti vendor kanë qenë të pjesshme. Punët aty dua t’i bëj me projekte të plota.

Lagjet e qytetit të Përmetit janë thuajse të harruara, ka mungesë gjelbërimi dhe ndriçimi. Sfidë ime është shtrirja e rilindjes urbane në rilindje rurale sepse kjo do të ndikojë në zhvillimin e turizmit”, tha znj. Hoxha. Ajo shtoi se do të jetë një mbështetje e madhe për biznesin, veçanërisht për gratë biznesmene, ato që kanë punishte të vogla, e që punësojnë gra të tjera me kohë sezonale.

Z. Ilir Xhakolli, Bashkia e Pogradecit

Në radhë të parë kemi një plan për liqenin, sepse sot vazhdojnë të derdhen mbeturina dhe ujërat e zeza të njësive administrative. Unë kam projekt për të rregulluar sistemin e ujërave të zeza të njësive Buçimas dhe Udenisht dhe tek përrrenjtë që derdhen në liqen. Operatori që do mirëmbajë apo pastrojë qytetin, do ta ketë të detyruar të blejë një pajisje për pastrimin e bregut të liqenit. Ky është kusht që liqeni të jetë i mirëmenaxhuar”.

Një tjetër projekt do të jetë rregullimi i fasadave për ta bërë nga një qytet gri që është sot në një qytet të bukur e të lulëzuar siç e meriton Pogradeci. Emergjente është edhe ndërhyrja në fshatrat e Pogradecit, pasi nga 73 fshatra të bashkisë, 53 prej tyre kanë problem me ujin e pijshëm, ujërat e zeza dhe kanalet vaditëse. Ne do të rivitalizojmë edhe sportet e vjetra dhe lojërave të ndryshme në liqen. Qyteti ka qenë qyteti më i zymtë nga të gjithë edhe në rastet e festave, sepse nuk ka pasur vëmendje nga bashkia e Pogradecit.

Z. Adriatik Zotkja, Bashkia e Poliçanit

Për infrastrukturën dhe shërbimet publike:

- Do të rikonstruktohen rrugët që lidhin njësitë administrative me qendrën e re administrative;
- Do të rikonstruktohet bulevardi qendror i qytetit;

- Do të rikonstruktohet Unaza e Plirzës;
- Do të krijohen qendra shëndetësore në çdo fshat dhe do të pajisen me të gjitha mjetet e nevojshme;

Për arsimin, kulturën dhe sportin:

- Do të ketë punësim sezonal të të rinjve;
- Do të rikonstruktohet shkolla fillore “Refat Keli” dhe ajo e mesme “Muhamet Kondi”;
- Do të vendoset transport për nxënësit në Dodovec, Vokopolë dhe Tozhan;

Për turizmin dhe mjedisin:

- Do të pajisjen të gjitha zonat me kontenier për grumbullimin e mbetjeve rurale me makina teknologjike;
- Do të krijohet një resort historiko-turistik, duke pasur ne fokus aktivitetin e Kombinatit Mekanik Poliçan, për ta sjellë këtë dëshmi nëpërmjet artit dhe turizmit;

Për bujqësinë:

- Do të bëhet i mundur krijimi i qendrave për grumbullimin, ruajtjen dhe standardizimin e produkteve bujqësore, në territorin e bashkisë;
- Do të pyllëzohen kodrat rreth qytetit me dafinë dhe shegë, i cili do të sigurojë një treg për eksportin e tyre dhe do krijojë mundësinë për hapjen e rreth 500 vendeve të reja të punës;

Z. Nuri Belba, Bashkia e Prrenjasit

Kemi mundësuar për herë të parë pas 25 vitesh furnizimin me ujë të pijshëm për 6800 banorët e fshatrave Fajin, Kakavec dhe Dritaj. Së shpejti brenda muaji mars të vitit 2020 për të gjithë fshatrat e njësisë administrative Rajcë, Bardhaj dhe Sutaj, në këto zona do të ketë ujë të pijshëm 24 orë në ditë. Belba u zotua se ”për vitin që vjen e në vazhdim fëmijët e shkollës 9-vjeçare “Qybra Sokoli” dhe ata të shkollës “Dilaver Nezha” në Qukës do vazhdojnë mësimin në kushtet më optimale falë investimit dhe ambienteve të gjitha të rikonstruara totalisht. Ai tha se Prrenjasi si asnjëherë tjetër do të renditet në ato bashki të cilat kanë bërë sukses me investimet pasi kanë pasur në krye njerëz të përgjegjshëm. “Ne do të vazhdojmë me mbështetjen e kryeministrit Edi Rama ku do të investojmë në infrastrukturën rrugore e cila është e dobët në territorin e Bashkisë. Gjithashtu do të investohet në bujqësi dhe në punësim”.

Z. Gjon Gjonaj, Bashkia e Pukës

“Objektivi im madhor është që në katër vitet Puka të shndërrohet në një qytet të zhvillimit të turizmit gjithëvjeter”. Gjonaj u premtoi mbështetje financiare për projektet më të mira nga të rinjtë që merren me zhvillimin e turizmit në bashkinë e Pukës. Gjithashtu Gjonaj premtoi taksë zero për vitin e parë të çdo aktiviteti në fushën e turizmit Gjonaj theksoi se në 4-vjeçarin e ardhshëm do të bëhet rivitalizimi i liqenit të Kukajve dhe lidhja e dy liqeneve me infrastrukturë urbane. Ai u premtoi të rinjve edhe këndin e lojërave të aventurës.

Z. Pali Polefski, Bashkia e Pustecit

Furnizimi me ujë të pijshëm është një nga problemet më të mëdha. Largimi i mbeturinave mbetet një temë e dhimbshme që duhet bërë sa më shpejt. Ndërtimi i infrastrukturës modern dhe kanalizimet janë gjithashtu një prioritet. Do të japim mbështetje për arsimin, ndihmë për fëmijët në nevojë, kabinete dhe laboratorë në shkolla. Do të ndërtojmë objekte sportive, terrene për lojërë të fëmijëve që mungojnë. Transparencë të plotë në shpenzimet e burimeve financiare të bashkisë. Çdo qytetar duhet të jetë në gjendje të marrë përgjigje të shpejtë.

Kryetari i bashkisë është i qytetarëve dhe zëri i tyre duhet të dëgjohet. Qytetarët duhet të njihen me të gjitha projektet dhe të japin sugjerimet e tyre. Objektivi jonë do të jetë puna dhe tërheqja e investimeve vendase dhe të huaja. Të punojmë për një të ardhme të mirë për fëmijët tanë dhe kjo varet nga ne.

Zj. Majlinda Bufi, Bashkia e Roskovecit (rikandidim)

Infrastrukturë dhe shërbime publike

- Do të hartohet Plani Rregullues Urbanistik;
- Do të kryhet rikonstruksion i plotë i rrugëve në lagje, duke përfshirë trotuarë, ndriçim dhe gjelbërim;
- Do të ndërtohet rrjeti plotë i kanalizimit të ujërave të zeza, në të gjitha lagjet e qytetit, duke synuar dhe ndërtimin e inplantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe teknologjike;
- Do të krijohen hapësira të gjelbëra në qytet, si lulishte, ambiente çlodhëse dhe argëtuese në çdo lagje;
- Do të përmirësohet shërbimi shëndetësor në çdo njësi të banuar, përmes rikonstruksionit të infrastrukturës ndërtimore dhe plotësimit me pajisjet e duhuara shëndetësore.

Arsimi, kultura dhe sporti

- Do të kthehet në tadtë organizimi i kampionateve sportive midis shkollave
- Do të kryhet rikonstruktion i shkollës në Jagodinë;
- Do të kryhen ambiente të reja sportive në shkollën e Kurjanit;

Bujqësia

- Do të zgjidhet problemi i tokave bujqësore;
- Do të krijohet infrastrukturë e përshtatshme për bujqësinë;

Ekonomia dhe punësimi

- Do të krijohen politika lehtësuese për bizneset dhe kompanitë që ushtrojnë aktivitetin në bashki me qëllim punësimin e banorëve vendas;
- Do të ketë mbështetje për të rinjë e diplomuar për tu punësuar në administratën e bashkisë;

Z. Haxhi Memolla, Bashkia e Rrogozhinës

U zotua se do të kthente vëmendjen nga qytetarët duke rritur cilësinë e shërbimeve për të gjithë qytetarët e këtyre njësive dhe zhvilluar zonën me programe konkrete zhvillimi duke sjellë kështu rritjen e cilësisë së jetës për këto zona.

Z. Pëllumb Binaj, Bashkia e Selenicës

Do të jemi krah për krah duke fol më pak dhe duke punuar më shumë, duke ulur kokën në punë, por duke mbajtur shikimin përpara larg. Bashkinë e Selenicës do ta kthejmë tek PS, atje ku i takon dhe të gjithë dinë se çfarë ndodh kur e merr në dorë PS, shikoni Vlorën dhe ajo flet vetë, transformimet epike që kanë ndodhur, jo vetëm na bëjnë krenarë, por ato na japin besimin e plotë, se ne mund të ndryshojmë rrënjësisht situatën edhe në bashkinë e Selenicës dhe do të bëjmë çfarë është e mundur për ta kthyer atë në një model suksesi, pavarësisht shtrirjes së madhe dhe sfidave të panumërta që ajo paraqet. Kryeministri, Qeveria dhe deputetët që po bëjnë të pamundurën për ndërtimin e rrugës së Lumit të Vlorës, projektin më madhor të krahinës së Labërisë.

Z. Adriatik Mema, Bashkia e Skraparit

Duke ju ofruar qytetarëve shërbimet e duhura sipas konceptit, zyrat e bashkisë do të shkojnë tek qytetarët, dhe jo qytetari tek zyrat e Bashkisë. Marrëdhënia me ta dhe komunitetin do të marrë një dinamikë të re, sipas së cilës do të jetë komuniteti ai që do të vendosë për iniciativat e zhvillimit. Në bashkisë e së nesermës do të punojnë aq punonjës, sa është e nevojshme për qytetarin, dhe jo aq sa vota i duhen kryetarit. Taksat e paguara nga qytetarët do të shkojnë në investime dhe të mira publike për ta. Drejtimi i Bashkisë nga Partia Socialiste do të bëjë të mundur që fryma transformuese dhe e modernitetit do të reflektohet më së miri nga Qeveria Rama që do të ketë impaktin e saj edhe në Skrapar.

Z. Elton Arbana, Bashkia e Shijakut

- Dua të përpiqem ta bëj Shijakun një vend sa më të mirë për fëmijët tanë;
- Do të bëjmë më shumë për integrimin e zonave rurale dhe ubrane.
- Mbështetje dhe përkrahje për çdo problematikë të tregtarëve të pazarit;
- Fëmijët e Qendrës Komunitare Shijak, do të kenë prioritet të veçantë;
- Në vëmendjen tonë do të jenë takimet me përfaqësues mjedisorë ku do të flasim më konkretisht për programet e mbrojtjes së mjedisit, zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes, menaxhimin e ujërave të zeza, parandalimin e përmytjeve në Shijak;
- Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbështetjes së moshës së tretë, të cilët kanë dhënë një kontribut të vyer për shoqërinë.

Z. Valdrin Pjetri, Bashkia e Shkodrës. Ka dhënë dorëheqje. Për momentin vazhdon të ushtrojë mandatin e saj që nga viti 2015 zj. Voltana Ademi.

Kryefjala e çdo takimi fillon me infrastrukturë, kopshte, çerdhe të gjitha këto të detajuara në programin tonë elektorale të qeverisjes së katër viteve të ardhshme. Djepit të kulturës dhe qytetarisë, do t'i kthejmë shkëlqimin e dikurshëm. Ne kemi konstatuar veç infrastrukturës nga takimet me grupet e interesit, është vënë re edhe mungesa e investimeve në Shkodër. Rinia tenton të largohet nga Shkodra. Kemi ndërtuar një program edhe për të rinjtë shkodranë, duke i dhënë mundësi punësimi nesër edhe pranë institucionit të bashkisë Shkodër. Për herë të parë do të fusim skemën e financimit të startup-eve. Nëse një i ri ka një projekt për të nisur një biznes por i mungojnë financat, bashka do të ketë një staf të dedikuar, një drejtor të dedikuar vetëm për pjesën e financimit të tyre. ndërtimin e disa tregjeve, ku produktet të shiten në mënyrë të diferencuar, ku të shitet bulmeti, peshku, etj. “Jo një treg që shkon dhe blen gjithçka aty. Kjo vlen edhe për shitësin për kushte me të mira, por edhe për blerësin që blen në një ambient më higjienik”, – tha ai.

Z. Rexhë Byberi, Bashkia e Tropojës

U ka premtuar banorëve të majtë e të djathtë se do të jetë shërbëtori i tyre. Ka premtuar se me qeverinë e Ramës do të rriten investimet me qëllim që edhe tropojanëve tu rikthehet shpresa

Zj. Juliana Mema, Bashkia e Urës Vajgurore

Në katër vite, sfidë ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit, por tani ka ardhur koha për bashkinë e së ardhmes, bashkinë e gjeneratës tjetër. Kërkon nga qytetarët një mandat të dytë për të vijuar me projektet që sipas saj, nxitën zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Tashmë do duhet të ndërtojmë bashkinë e së ardhmes dhe vizioni im për mandatin e dytë lidhet me amplifikimin e identitetit të bashkisë duke e parë si portë hyrëse drejt Beratit, që turistët ta konsiderojnë një pikë të bukur ndalëse para se të shkojnë në Berat. Kemi një projekt për fazën e dytë të mbrojtjes lumore që do të vazhdojë, po ashtu ndërtimi i dy urave që do të jenë brand i qytetit tonë për ta bërë atraktiv. Në fokus do të kemi edhe zhvillimin e artit dhe të kulturës me një projekt për vënien në punë të teatrit bashkëkohor.

Z. Mark Babani, Bashkia e Vaut të Dejës

Besoj që aftësitë menaxheriale janë pika ime e fortë. Duke parë bashkinë aktuale, pa një orientim të duhur, me një infrastrukturë të mjeruar që lë për të dëshiruar, duke parë bujqësinë dhe blegtorinë që sjell mundësi të mëdha, por sot le për të dëshiruar. Në tre muajt e parë të mandatit tonë, ne do të kryejmë ndërhyrjet më emergjentë në infrastrukturë. Iniciativa që kam marrë është të zhvillojmë bujqësinë si në të gjithë Europën”, tha Babani. Zona e Barbullushit, dhe pjesë e malit të Jushit dhe Trushit janë hambari i bashkisë sonë për drithëra dhe prodhime bujqësie ka problematikë përmytjen dhe masa e parë që do marrim është pjesa e kullimit dhe vaditjes që janë kryesore për zhvillimin e zonës. Duhet një planifikim i mirë i fermave blegtorale se ku duhen ndërtuar. Kemi zona të përkryera për frutikulturë. Të rinjtë tanë punojnë në Torino me frutikulturën, kanë eksperiencën që mund ta aplikojnë në tokat tona. për të nxitur rritjen e punësimit në zonë, duke shfrytëzuar potencialet natyrore të zonës. ”Sot Laçi i Vaut të Dejës është një qytet që vetëm i tillë nuk mund të quhet. Mundësia e punësimit në këtë qytet është e pamundur, kjo popullsi do të punënohet ose në bashki, ose në ndërmarrjet shtetërore. Pra na duhet një strategji për këtë pjesë dhe ne kemi afër një liqen nga më të bukurit në Europë, për të cilin askush nuk ka patur ide se çfarë mund të prodhojë ai. Liqenin duhet ta bëjmë të lundrueshëm, sepse turizmi kështu do të pësojë rritje. Nëse në fshatrat e vjetër si Lisna, Karma, rikonstruktojmë shtëpitë e braktisura, ne kemi mundësinë që gradualisht t’ju krijojmë shpresën banorëve me këto lloj biznesesh turistike.

Z. Agim Kajmaku, Bashkia e Vorës. Ka dhënë dorëheqje dhe për momentin Bashkia e Vorës nuk ka kryetar.

Ne do ti sjellim kësaj bashkie Rilindjen Urbane, dhe për banorët e kësaj zone do të ofroj të gjitha shërbimet e munguara pasi është e pafalshme mungesa e ujit të pijshëm në vendin e 7 liqeneve, si dhe mungesa e rrugëve në udhëkryqin mes veriut dhe jugut, lindjes dhe perëndimit. Kajmaku premtoi se “do të jem një kryetar bashkie model për banorët e Vorës, ai model që Partia Socialiste e Shqipërisë dhe vetë Kryeministri Edi Rama ka krijuar.

Tre nga bashkitë (Vorë, Shkodër, Durrës) për momentin (30 Prill 2020) janë pa kryetarët e zgjedhur në zgjedhjet e 30 Qershorit 2019. Në bashkinë e Shkodrës vazhdon të ushtrojë mandatine Kryetarit të Bashkisë zj. Voltana Ademi e zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2009.